

SHQIPËRI

WIND

CALL YOUR COUNTRY

TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
INFORMACIONE WIND.IT

Bota shqiptare

www.shqiptariitalise.com

SHQIPËRI

WIND

CALL YOUR COUNTRY

TELEFONO NË SHQIPËRI DUKE FILLUAR
ME NGA 5 QINDARKA NË MINUTË
INFORMACIONE WIND.IT

il mondo albanese
IL GIORNALE DEGLI ALBANESE IN ITALIA
Quindicinale - Anno XIII - Nr. 263
16 - 31 luglio 2011 € 1,50

Iscrizione Registro Stampa del Tribunale di Roma nr. 213/99 del 12.05.99 (cambiamenti in corso). Iscrizione ROC nr 13252. Direttore Responsabile Roland Sejko Stampa: CSQ - Centro Stampa Quotidiani S.p.A Erbusco, BS. Distribuzione nazionale edicole: Messaggerie Internazionali SpA. Tariffa R.O.C.: Poste Italiane s.p.a. - Sped. A.P. - D.L. 353/2003 (L. 46/2004) art.1, c.1,1 - CNS/AC - Roma

ISSN 1720-3678 0 0 2 6 3
9 771720367001

Redazione: Via Eleonora Duse 53, 00197 Roma. Tel 06-94354511 Fax 06-97998632. Email: botashqiptare@stranieriinitalia.it

Turizmi që mashtron

Nga Armand SHKULLAKU

I huaji mund të shijojë kënaqësitë e një turi bregdetar, të provojë peshkun e freskët, të kthejë ndonjë gotë tek Ha-



vana apo Lolly Pop apo të habitet duke parë një gomar të vërtetë që shërben ende si mjet transporti. Por ama gjithçka mbyllet këtu. Gazetarët e huaj, të befusuar nga një vend që e zbulojnë për herë të parë dhe të kufizuar në kohë, nuk arrijnë në brendësi të problemit kryesor të turizmit shqiptar. Niveli i dobët dhe kultura mediokre e operatorëve turistikë të jugut së bashku me indiferencën e qeverisë po e kthen në zhgënjim rrëfimin për bregdetin magjik të Jonit.

faqja 9

PENSIONET SOCIALE NË RREZIK

Gjithnjë e më e vështirë të marrësh e të mbash pensionin social. Nevojiten 10 vjet rezidencë në Itali, karta e qëndrimit dhe banim efektiv dhe i zakonshëm në Itali për ta përfituar. Natyrisht edhe mungesa e të ardhurave apo të ardhura, përfshirë edhe ato në vendlindje, më të ulëta se kufijtë e parashikuar me ligj

Çeku ka karakter të përkohshëm, pra jepet për aq kohë sa përmbushen kriteret.

Çdo vit, në fakt, në periudhën maj-qershor, titullarët e çekut social duhet të deklarojnë, me një formular të posaçëm, nëse të ardhurat e tyre kanë ndryshuar, nëse kanë mbajtur rezidencën në Itali apo nëse është transferuar jashtë shtetit, dhe së fundi edhe nëse kanë qenë të shtruar në ndonjë strukturë publike me shpenzime në ngarkim të shtetit.

Shtrengohen kriteret për ta marrë, e paralelisht shtohen kontrollet e Inps-it ndaj atyre që e përfitojnë. Kronika e fundit flet për 23 të moshuar jokomunitarë në Modena që akuzohen për mashtrim ndaj shtetit, sepse kanë marrë pension social pa plotësuar kriteret. Mes tyre edhe 4 shqiptarë.

faqja 2-3



Katër i Radës è salva

Grazie all'intervento di Klodiana Çuka e della sua associazione Integra On-lus, diventerà un monumento a Otranto



La notizia ha suscitato la felicità partecipata di tutti i volontari e operatori di Integra, ma anche di tanti amici albanesi e italiani che hanno preso a cuore la salvezza della nave e che hanno seguito la faccenda costantemente in tutti questi anni. L'intento è quello di rendere del relitto un vero e proprio monumento della memoria che apra uno spaccato storico-culturale affinché la memoria della tragedia non si perda, ma permanga testimone di una pagine di storia che non sbiadirà mai

faqja 6

SHQIPTARË TË ITALISË

LORIK CANA shqiptarja e Lazios prapë kuqezi



MASHTRIMI I MADH I SANATORES

Legalizimet e rreme të paguara shtrenjtë



Që çdo sanatore është terren pjellor për mashtruesit është tashmë e ditur dhe e natyrshe. Në çdo shtet me qindra mijëra të parregullt është e lehtë të gesh të dëshpëruar të gat-

shëm të paguajnë shtrenjtë edhe vetëm premtimin e një lejeqëndrimi. Sanatoria e vitit 2009, në këtë këndvështrim, ishte goxha e leverdishme. Janë me mijëra të mashtruarit me legalizimin e shtatorit 2009, por nuk mund të denoncojnë askënd. NAGA tregon ç'ka ndodhur në Milano dhe kërkon: "Leje qëndrimi për ata që denoncojnë, por të ndryshojmë edhe rregullat i imigracionit".

One Nation You&Me

Ti dhe vendi yt më pranë se kurrë

power to you



Bota shqiptare

il giornale degli albanesi in italia

testata vincitrice del premio giornalistico M. Souhir per la multiculturalità nei media come MIGLIOR GIORNALE PER GLI STRANIERI IN ITALIA

viti XIII i botimit / anno XIII

E përdjashme informative-kulturore e shqiptarëve në Itali.

QUINDICINALE DI INFORMAZIONE E CULTURA DEGLI ALBANESE IN ITALIA.

BOTIM I / EDITORE

Keti Biçoku
Via Domenico Ragona 41,
00143 Roma

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës me dekret

TESTATA ISCRITTA AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA n. 213/99 del 12.05.1999

REDAKSIA / REDAZIONE
Via Eleonora Duse 53,
00197 ROMA

Tel. 06-94354511
Fax 06-97998632
Cell. 393-9712595

www.shqiptariitalise.com
botashqiptare@stranieriinitalia.it

DREJTOR/DIRETTORE RESPONSABILE
Roland Sejko

REDAKSIA / REDAZIONE
Keti Biçoku, Irida Cami

BASHKËPUNËTORË/ COLLABORATORI
Rando Devole, Giuseppe Chimisso, Albana Temali, Afërdita Shani, Ivan Muccari (grafico)

LEGISLACION EMIGRACIONI
LEGISLAZIONE D'IMMIGRAZIONE A CURA DI
Stranieri in Italia srl, Roma
www.stranieriinitalia.it

REKLAMAT/ PUBBLICITÀ
Tel. 06-94354505
pubblicita@stranieriinitalia.it

PAJTIMET/ ABBONAMENTI
Tel. 06-94354507
distribuzione@stranieriinitalia.it

SHTYPI / STAMPA
Centro Stampe Quotidiani spa
Via dell'Industria 52,
25030 Erbusco (BS)

Shpërndahet në të gjithë Italinë në pikëshitjet me shtyp në gjuhë të huaj

DISTRIBUZIONE NAZIONALE
NELLE EDICOLE DI STAMPA ESTERA
Messaggerie internazionali SpA
Via A. Manzoni, 8
20089 Rozzano (MI)
Tel. 02-57512612

DORËSHKRIMET NUK KTHEHEN.
ARTIKUJT E PANËNSHKRUAR JANË TË REDAKSISË

GREQIA NË KRIZË

Kontrolle të rrepta shqiptarëve që atje përfitojnë pension

Rreth 21 mijë shqiptarë marrin 360 euro pension në Greqi. Enti i sigurimeve shoqërore Agrare (OGA) do të nisë një fushatë kontrolli për të parë sa prej tyre plotësojnë vërtet kriteret

Agjencia greke e lajmeve Athens News Agency (ANA), njofton se Enti i sigurimeve shoqërore Agrare (OGA) do të kalojë "në shoshë" rreth 21.000 shtetas shqiptarë me kombësi greke të cilët marrin pension nga Greqia. Kontrolli po bëhet pasi kohët e fundit është konstatuar se përfitojnë pension edhe persona që nuk e kanë këtë të drejtë.

Pas një pyetjeje nga deputeti i LAOS-it, Kiriakos Velopulos, me të cilën paralajmëron qeverinë për mundësinë e deklarimeve të rreme nga shtetas shqiptarë, me qëllim që të përfitojnë pension nga OGA, ministri i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore, Jorgos Kutrumanis, ka dërguar një shkresë në Parlament, ku informon se OGA përmes një llogarie u ofron çdo muaj pension dhe përkujdesje shëndetësore shtetasve grekë dhe "homogjenëve" (siç quhen në Greqi shqiptarët me prejardhje greke) të moshuar të cilët banojnë në Greqi, përderisa vërtetojnë se janë të pafuqishëm ekonomikisht dhe se ata dhe bashkëshortët e tyre nuk përfitojnë pension apo asistencë tjetër, më të lartë nga pensioni që ofron Enti i Sigurimeve Agrare, me vlerë 360 euro.

Por ministri Kutrumanis nënvizon se "kohët e fundit është konstatuar se në Amzën e pensionistëve homogjenë të OGA, përfshihen edhe persona që nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit".

Prandaj, nga shërbimet kompetente, bashkë me përditësimin e Amzës, po kryhen edhe verifikime për të gjithë pensionistët, përfshirë edhe homogjenët, për të parë nëse përmbushin kriteret.

"Përmes kësaj procedure", thekson ministri i Punës, "synohet që të verifikohet nëse përfituesit e kësaj kategorie janë në jetë, nëse kanë vërtetë origjinë greke, etj".

Ministri informon gjithashtu deputetin, se në kuadër të këtij kontrolli u kërkuan nga pensionistët homogjenë, numri i të cilëve është rreth 21.000 vetë, të dhëna të reja, siç është letërnjoftimi elektronik shqiptar me të cilin janë pajisur thuajse të gjithë shtetasit shqiptarë si dhe pasaporta biometrike që jepet edhe në ambasadën shqiptare në Greqi, që përbëjnë elementët kryesorë të identifikimit.

PENSIONI I EMIGRANTIT

Nuk do të kem kurrë PENSION NGA PUNA, a mund të kërkoj PENSIONIN SOCIAL?

Jam shqiptar, kam punuar në Itali, por shpesh në të zezë, ndaj nuk kam aq vite kontribute për pension. Pas pak mbush 65 vjeç, a kam të drejtë të kërkoj çekun social? Çfarë kushtesh duhet të plotësoj që të mund ta kërkoj? Si paraqitet kërkesa?

Çeku social është një lloj ndihmese e natyrës ekonomike që jepet nga INPS, instituti italian i sigurimeve shoqërore. Është një shëmbë në para, tip asistence e ndihmë për të moshuarit që janë në gjendje jo të mirë ekonomike. Për të pasur të drejtën e këtij çeku nuk është e nevojshme të kesh derdhur kontribute. Por natyrisht, jo të gjithë kanë të drejtë të marrin këtë çek, që ta përfitojnë duhet të plotësojnë disa kushte të përcaktuara. Madje është mirë të dihet që e drejta e çekut nuk është e përhershme, jepet vetëm për sa kohë plotësohen kushtet.

Kriteret për marrjen e çekut social

Për të përfituar çekun social, personi duhet të përmbushë këto kriteret:

- të ketë mbushur 65 vjeç;

- të ketë rezidencë në Itali efektive dhe të zakonshme prej të paktën dhjetë vjetëve (kriter i futur nga 1 janari 2009);
- të mos ketë asnjë të ardhur ose të ketë të ardhura nën kufijtë e përcaktuar me ligj.

Për vitin 2011, për të kërkuar çekun social, të ardhurat nuk duhet të kalojnë kufirin e 5.424,90 eurove në vit, të shumëzuara për dy, pra 10.849,80 euro, për personat e martuar. Edhe shtetasit e huaj kanë të drejtë të kërkojnë çekun social. Qytetarëve të BE-së nuk u kërkohet asgjë me shumë se italianëve, ndërsa jokomunitarët duhet të jenë titullarë të kartës së qëndrimit ose të lejes së qëndrimit BE për qëndruesit afatgjatë.

Kërkesa

Kërkesa për marrjen e çekut social duhet të paraqitet në INPS. Moduli mbi të cilin përpilohet kërkesa mund të shkarkohet drejtpërdrejt nga faqet on-

SHTOHEN FATKEQËSITË NË PUNË MES TË HUAJVE, PAKËSOHEN VDEKJET E BARDHA

Sipas Inail-it, ndryshe nga tendenca e përgjithshme e dukurisë, gjatë vitit 2010 vërehet rritje e numrit të aksidenteve në punë të punonjësve të huaj. Por bie numri i të ashtuquajturave "vdekje të bardha". Çdo dy të vdekur të huaj në punë një është rumun, shqiptar ose maroken

Raporti vjetor i Inail-it (Instituti Kombëtar për Sigurimin Kundër Fatkeqësive në Punë) dëshmon dhe një herë se fenomeni i vdekjeve në punë mbetet një plagë e vërtetë në Itali. Por për herë të parë në vitin 2010, që pas luftës aksidentet vdekjeprurëse në vendin e punës kanë rënë nën kuotën 1.000. Sipas Inail-it aksidentet në punë janë në rënie, megjithëse kjo rënie është shumë e vogël. Gjatë vitit të kaluar janë regjistruar 775.374 aksidente në punë, 1,9% më pak se 790.112 të vitit 2009 (rreth 15 mijë aksidente më pak). Vdekjet në punë kanë qenë 980, 6,9% më pak se 1.053 e vitit 2009.

Por nëse shifrat e përgjithshme të aksidenteve në punë janë ulur paksa, për

punonjësit e huaj, viti 2010 ka qenë më i rëndë se ai i mëparshmi. Nga 119.240 aksidente që të huajt kanë pasur në vendin e punës në vitin 2009, është kaluar në 120.135 në 2010. Janë shtuar në mënyrë të ndjeshme, në masën 6,8%, aksidentet mes grave të huaja. Për fat të mirë janë pakësuar me 4,2% rastet e aksidenteve vdekjeprurëse të cilat kanë kaluar nga 144 në vitin 2009 në 138 gjatë vitit të kaluar.

Fatkeqësitë në punë të të huajve përfaqësojnë 15,5% të të gjitha fatkeqësive, ndërsa në rastin e vdekjeve të bardha 14,1%. Në përpjesëtim me numrin e të punësuarve, të huajt lëndohen apo mbeten viktimat në vendin e punës më shpesh se kolegët e tyre italianë. Sepse



line të institutit në seksionin "modulistica". Pasi moduli përpilohet, ai mund të paraqitet pranë një zyre të INPS-it, ose t'i dërgohet me postë të porositur me lajmërim marrjeje, ose t'i përcillet përmes një Patronati që asiston falas të gjithë qytetarët që i drejtohen atij.

Kërkesës i bashkëngjitet, përveç një fotokopjeje të një dokumenti personal, edhe një autocertifikatë e rezidencës, një deklaratë e të ardhurave (përfshirë të ardhurat e marra në atdhe, si një pension, për shembull), dhe në rastin e qytetarëve joko-munitarë, edhe fotokopja e kartës së qëndrimit apo e lejeqëndrimit BE për qëndruesit afatgjatë.

Shuma

Shuma e çekut vlerësohet çdo vit, dhe për vitin 2011 është përcaktuar 417,30 euro në muaj, për 13 herë në vit.

Nëse kërkuesi ka edhe të ardhura të tjera, (pension në atdhe, dëmshpërblime të paguara nga shteti italian apo shtete të tjera)

shuma vjetore e çekut social do të jetë sa diferenca mes kufirit të parashikuar çdo vit për të pasur të drejtën e çekut (5.424,90 për vitin 2011) dhe të ardhurave të deklaruara.

Derdhja e çekut nis nga dita e parë e muajit pasardhës së atij të paraqitjes së kërkesës. Shuma e parave mund të derdhet, me kërkesë të të interesuarit edhe drejtpërdrejt në llogarinë rrjedhëse në bankë apo postë.

Çeku ka karakter të përkohshëm, pra jepet për aq kohë sa përmbushen kriteret.

Çdo vit, në fakt, në periudhën maj-qershor, titullarët e çekut social duhet të deklarojnë, me një formular të posaçëm, nëse të ardhurat e tyre kanë ndryshuar, nëse kanë mbajtur rezidencën në Itali apo nëse është transferuar jashtë shtetit, dhe së fundi edhe nëse kanë qenë të shtruar në ndonjë strukturë publike me shpenzime në ngarkim të shtetit.

Avv. Andrea De Rossi

kronika

MERRNIN PENSIONIN SOCIAL PA PASUR TË DREJTË

23 të moshuar të huaj akuzohen për mashtrim ndaj shtetit, sepse kanë marrë pension social pa plotësuar kriteret. Mes tyre edhe 4 shqiptarë

Gazeta Il Resto del Carlino bën të ditur se Policia Financiare (Guardia di Finanza) e Modenës ka zbuluar 23 shtetas të huaj që merrnin pensionin social pa pasur këtë të drejtë për shkak se kishin deklaruar se jetonin në provincë gjë që ka rezultuar e pavërtetë.



Janë kryer kontrole të imëta mbi pensionet që Inps-i jep për personat me banim në Itali, që kanë mbushur moshën 65 vjeçare e nuk kanë të ardhura të tjera. Dhjetë marokenë, katër shqiptarë, dy argjentinas, dy estonezë, një brazilian, një polak dhe një spanjoll akuzohen tani për mashtrim ndaj shtetit dhe përfitim të padrejtë nga ndihmat shtetërore. Përveç se ndërprerjes nga ana e Inps-it të pensionit, personat duhet të kthejnë edhe shumat e marra padrejtësisht. Një nga kushtet kryesorë për të marrë këtë pension,

prej janarit të vitit 2009, është edhe banimi pa ndërprerje prej të paktën dhjetë vjetësh në Itali dhe pasja e kartës së qëndrimit për joko-munitarët. Këtë vit çeku social është 417,30 euro në muaj. Por është pension që u takon vetëm rezidentëve, dhe duket se INPS-i ka vendosur t'u presë rrugën "dinakëve" dhe të verifikojë një më një plotësimin e të gjitha kushteve, veçanërisht atë të rezidencës, që duhen përmbushur për përfitimin e çekut. E?ka filluar në maj 2008 në Alba duke ndëshkuar katër vetë, dy shqiptarë e dy marokenë.

punojnë në sektorët më me rrezik si ndërtimi, industria mekanike dhe e metaleve, por edhe për shkak se njohin më pak rregullat e sigurisë në punë apo sepse, për motive të ndryshme, nuk i zbatojnë ato.

Shqiptarët janë ata që bashkë me marokenët dhe rumunët pësojnë më shumë fatkeqësi në punë. Këto tri kombësi së bashku preken nga 39,2% e fatkeqësive në punë të huajve, madje po të shihen rastet e vdekjeve të bardha, kjo arrin në 48,5%, pra rreth gjysma e vdekjeve të bardha në punë të emigrantëve gjatë vitit 2008 ka pasur si viktimë një rumun, një shqiptar ose një maroken.

Gjatë vitit 2010 janë më të shumtë rumunë, personat që kanë denoncuar një aksident në punë (rreth 18.900) ashtu edhe ata që kanë humbur jetën në punë (30 persona). Maroku radhitet i dyti me 16 mijë raste fatkeqësie në punë, që renditet i treti për sa i përket rasteve vdekjeprurëse (12). Shqipëria, më 12.286 raste aksidentesh në punë, ka kaluar nga vendi i tretë në vendin e dytë të listës së dhimbshme të vdekjeve në punë, me 25 raste gjatë vitit 2010. Për fat të keq, viktimat mes punonjësve shqiptarë gjatë vitit 2010 përbëjnë 18,1% të të gjitha viktimave të huaja, ndërsa në vitin 2009 ata përbënin vetëm 11,3%.

Ir.Ca.

NË GJYQ DREJTUESIT E NDËRMARRJES PËR LËNDIMIN E RËNDË TË PUNONJËSIT

Punonjësi shqiptar ka pësuar thyerje të shumta kockash dhe dëmtime aq të mëdha sa i është njohur një ë invaliditet të përhershëm në masën 70%

Tavola n. 19 - INFORTUNI occorsi a lavoratori STRANIERI per Paese di nascita
TUTTE LE GESTIONI - Anno 2010

Infortuni			Casi mortali		
Paese di nascita	N.	%	Paese di nascita	N.	%
Romania	15.937	15,7	Romania	39	21,7
Morocco	15.004	13,3	Albania	25	13,1
Albania	12.790	10,2	Morocco	12	6,7
Tunisia	4.235	3,5	Germania	6	4,3
Svizzera	3.606	3,2	Moldavia	6	4,3
Germania	3.554	3,0	Tunisia	4	2,0
Ex-Jugoslavia	3.128	2,6	Macedonia	4	2,9
India	2.905	2,4	Francia	4	2,9
Perù	2.891	2,4	Belgio	4	2,9
Senegal	2.875	2,4	Bulgaria	4	2,9
Moldavia	2.841	2,4	Svizzera	3	2,2
Ecuador	2.391	2,0	India	3	2,2
Egitto	2.307	1,9	Senegal	3	2,2
Macedonia	2.290	1,9	Egitto	3	2,2
Altri paesi	29.763	35,1	Altri Paesi	27	13,6
Totale	125.135	100,0	Totale	135	100,0

Në gjykatën e Cuneos u zhvillua seanca e dytë gjyqësore për aksidentin e shqiptarit K.R., punonjës i firmës A.R. Costruzioni i cili më 28 prill të vitit 2008 u godit nga një kafaz metalik që lëvizte mbi shina, i kapur me katër zinxhirë në cepa. Prokuroria ka akuzuar punëdhënësen e viktimës dhe përgjegjës për sigurinë në ndërmarrje si përgjegjës për aksidentin e rëndë. Punonjësi shqiptar ka pësuar thyerje të shumta kockash dhe dëmtime aq të mëdha sa i është njohur një ë invaliditet të përhershëm në

masën 70%. Gjatë seancës u dëgjuan disa dëshmitarë. Meqenëse në seancën e mëparshme kolegët e punëtorit shqiptar patën deklaruar se kllapat e sigurisë që duhet të ndalonin daljen e kafazit nga shinat, ishin tepër të konsumuara nga përdorimi, gjykatësi pati vendosur që të bëhej një shqyrtim nga ana e specialistëve. Kllapat e sigurisë ishin ndërruar menjëherë pas aksidentit dhe nga ekspertiza e specialistëve ka dalë se ato nuk ishin të mirëmbajtura. Konsulenti teknik i palës akuzuese deklaroi se duhej të ishin përdorur zinxhirë të një lloji tjetër dhe më të gjatë, kjo mund të kishte evituar aksidentin. Gjithashtu një specialist i Asl i Savignanos, i cili ishte lajmëruar për aksidentin vetëm një ditë më pas, deklaroi se ka pasur minimumi neglizhencë nga ana e ndërmarrjes. Përgjegjësi për sigurinë i ndërmarrjes rezultoi se nuk rezultoi i emëruar për këtë post, ai ishte thjesht drejtues i punimeve. Nga seanca doli gjithashtu se kursi i bërë punonjësve për sigurinë në punë kishte qenë shumë i sipërfaqshëm, me shikimin e disa diapozitivave dhe pa i dhënë punonjësve fotokopjet e rregullave të sigurisë që duhet të ndiqnin në vendin e punës.

Meqë rrjedhjat e aksidentit janë ende të pranishme, gjykatësi vendosi që të kryhen shqyrtime të mëtejshme mjeko-ligjore.

SHQIPËRIA ËSHTË GJITHNJË MË PRANË.



CALL YOUR COUNTRY

FLET ME SHQIPËRINË ME 5 QINDARKA NË MINUTË ME NUMRAT E RRJETIT FIKS,
10 QINDARKA NË MINUTË ME CELULARËT.
FALAS NË PROMOVIM KOSTOJA SEMESTRALE PËR 6 MUAJT E PARË.

DHE ME **SUPER NOI WIND**
KE 400 MINUTA DHE 400 SMS E MMS ME TË GJITHË NUMRAT WIND
ME VETËM 3€ NË JAVË PA KOSTO AKTIVIZIMI.

Dhe nëse e aktivizon brenda datës 4/9/2011 **SUPER NOI WIND** të kushton **vetëm 2€** në javë për tre muajt e parë.



ATTIVA CALL YOUR COUNTRY
CON UN SMS GRATUITO
INQUADRANDO IL CODICE
CON IL TUO SMARTPHONE



ATTIVA SUPER NOI WIND
CON UN SMS GRATUITO
INQUADRANDO IL CODICE
CON IL TUO SMARTPHONE

Zgjidh Wind. Duke telefonuar në **155**, dëgjon risitë dhe merr asistencë në gjuhën **shqipe**.
PËR MË SHUMË INFORMACIONE MBI KOSTOT, KUSHTET DHE KUFIZIMET, SHKO NË WIND.IT

Call Your Country: Shkrehje në përgjigje 16 cent. Tarifimi çdo 60 sekonda. Kosto semestrale 4€.
Për klientët e rinj aktivizimi i Call Your Country 7€, falas deri më 4/9/2011.


WIND
Più vicini.

Që çdo sanatore është terren pjellor për mashtruesit është tashmë e ditur dhe e natyrshme. Në çdo shtet me qindra mijëra të parregullt është e lehtë të gesh të dëshpëruar të gatshëm të paguajnë shtrenjtë edhe vetëm premtimin e një lejeqëndrimi.

Sanatoria e vitit 2009, në këtë këndvështrim, ishte goxha e leverdishme. E kufizuar vetëm për bashkëpunëtorët familjarë, në një kohë kur po ashpërsoshin dënimet për klandestinët, la jashtë qindra dikë të gatshëm mijëra punonjës, duke detyruar shumë prej tyre të shpëtonin duke gjetur (dhe paguar) dikë të gatshëm që të deklaronte se e ndihmonin në punët e shtëpisë apo për t'u kujdesur për një familjar.

Një lumë parash ka dalë nga xhepat e klandestinëve për të hyrë në ato të ndër-mjetësuesve dhe të vetëquajturve punëdhënës. Që ose nuk kanë paraqitur fare kërkesën e legalizimit, ose e kanë paraqitur edhe pse nuk përmbushnin kriteret, ose kanë paraqitur shumë më tepër kërkesa nga ç'lejonte ligji. Duke pasur të njëjtin rezultat: ata janë bërë me një tufë para, ndërsa të huajt "e ndihmuar" prej tyre kanë mbetur siç ishin, klandestinë, pa pasur mundësi as t'i denoncojnë sepse po të shkojnë në polici, marrin vetëm fletën e dëbimit.

Sporteli legal NAGA në Milano ka dëgjuar historitë e mëse 400 imigrantëve që kanë rënë viktimë të këtij mekanizmi dhe ka përgatitur një raport që ka nxjerrë para pak ditëve. "Mashtrime. Kur ligji krijon ilegalitet". Raporti të lë të nënkuptosh që se janë normat e ndërlikuara italiane të imigracionit ato që ushqejnë e shtojnë rastet që shoqata përshkruan deri në detaje, duke dhënë profilin e të mashtruarve dhe të mashtruesve.

Kuponë të falsifikuar dhe takime të rreme

Mashtrimet janë nga më të ndryshmet. Për shembull, në raport jepet rasti i punëdhënësit që paraqet 47 kërkesa legalizimi (mban rekord për numër kërkesash të paraqitura), edhe pse e di shumë mirë që do të pranoheshin, maksimumi, tre, duke marrë gjithsesi paratë edhe për të gjitha kërkesat e tjera. Ka të tjerë që kanë falsifikuar kuponët e lëshuar nga siti i ministrisë së Brendshme. Të tjerë që kanë dhënë edhe takime të rreme, për t'u bërë qejfin klientëve të tyre e për t'u treguar se praktika po shkon përpara.

Ka nga ata që kanë inskenuar edhe takimin për firmën e kontratës së qëndrimit në zyrën e ndonjë miku, natyrisht jo në Sportelin Unik. "Më telefonoi ekonomisti - tregon viktimë - e më tha që kishte ardhur letra me datën e takimit dhe që duhet të shkoja për të firmosur kontratën e qëndrimit. Shkova dhe gjeta aty edhe punëdhënësin tim. Firmosa, e pastaj, në një dhomë tjetër më morën edhe shenjat e gishtërinjve. Pse nuk kam marrë akoma kuponin e lejes së qëndrimit?".

Mashtruesit, natyrisht, janë të paskrupuj. Një prej tyre kishte paraqitur një kërkesë legalizimi, kundrejt një pagese prej 3 mijë euro, edhe pse nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të punësuar dikë. Kur Sporteli unik ia ka vënë në dukje këtë fakt, tregon NAGA, "ka thirrur të huajin që po "ndihmonte" dhe i ka kërkuar atij integrimin e të ardhurave. Kështu viktimë i ka dhënë edhe 4.000 euro të tjerë (para të thata në dorë), dhe më pas nuk ka marrë vesh më asgjë për praktikën".

Raporti nxjerr në dritë që tarifa mesatare e marrë nga mashtruesit është tremijë euro për çdo kërkesë legalizimi. Punëdhënësit e rremë në 83% të rasteve ishin italianë dhe në 71% të rasteve ka pasur edhe ndërmjetësues. Të mashtruarit janë kryesisht burra, egjiptianë dhe

Legalizimet e rreme të paguara shtrenjtë: mashtrimi i madh i sanatores

Janë me mijëra të mashtruarit me legalizimin e shtatorit 2009, por nuk mund të denoncojnë askënd. NAGA tregon ç'ka ndodhur në Milano dhe kërkon: "Leje qëndrimi për ata që denoncojnë, por të ndryshojmë edhe rregullat i imigracionit"



Postat italiane nuk mund të përjashtojnë imigrantët nga ankandi për shitjen e apartamenteve të saj. Të fusësh mes kriterëve edhe shtetësinë përbën diskriminim.

Ky është mendimi i Zyrës Kombëtare Kundër Dskriminimeve Raciales, Unar, që i ka kërkuar shoqërisë Poste Italiane spa të udhëhequr nga Massimo Sarmi të të bëjë prapakthehu. Tani për tani kjo është thjeshtë një këshillë, por nëse Posta nuk vepron në këtë drejtim, pra t'u hapë rrugë edhe imigrantëve për të marrë pjesë në ankand, rrezikon të përfundojë përpara gjykatës.

Çështja ka të bëjë me faktin që kohët e fundit, shoqëria Poste Italiane ka nxjerrë në shitje disa apartamente që ka në pronësi në Brescia, Ferrara, Novara, Taranto, Vercelli e Verona. Shitja bëhet përmes një ankandi rregullat e të cilit janë botuar në faqet internet zyrtare të Postave. Ajo që bie në sy në rregulloren e ankandit është përjashtimi i të huajve, pasi në pikën 3 të rregullores shkruhet shprehimisht që në ankand marrin pjesë vetëm shtetas italianë.

Një diskriminim i tillë është i papranueshëm, por edhe paradoksal kur vjen nga një shoqëri që vitet e fundit ka bërë jo pak para nga të huajt e qëndrim dhe lejeqëndrim në Itali. Nga 6 nëntori i vitit 2006, falë konvencionit me ministrinë e Brendshme, ajo mbledh kërkesat që të huajt paraqesin për lejeqëndrimin e parë dhe përtëritjen e tij, kundrejt një pagese prej 30 eurosh për këtë shërbim. Meqë sipas të dhënave të ministrisë nga ajo datë deri në fund të vitit 2010, janë kërkuar mbi 1 milion e 670 mijë leje qëndrimi, Postat kanë marrë nga të huajt mbi 50 milionë euro. E pra, të huajt janë ndër klientët më "të mirë" të postave, ndaj diskriminimi është i pashpjegueshëm. Për më tepër, shkel normat ligjore: neni 9 i dekretit legjislativ 286/98, parashikon që "shtetasit e vendeve jo anëtare të BE-së me lejeqëndrim kanë të drejtë - veç të tjerash - të përfitojnë të mira e shërbime në dis-

që kanë jetuar e punuar ilegalisht në Itali mesatarisht për 4 vjet e 6 muaj para se të mund "të përfitonin" nga ajo që sipas tyre ishte shansi i vetëm i legalizimit.

Massarotto (NAGA): "Të ndryshohen rregullat"

"Hulumtimi dëshmon, edhe një herë, që problemi thelbësor është mosfunksionimi i mekanizmit të hyrjes së shtetasve të huaj për motive pune sipas normave në fuqi, por edhe i sanatoresve. Me rregullat aktuale, mashtruesve nuk u hyn gjemb në këmbë dhe nëse institucionet nuk do të marrin masa krimet e lidhura me "krimet e sanatores" do të kalojnë në heshtje" komenton Pietro Massarotto, president i NAGA-s.

Shoqata kërkon që atyre që denoncojnë këto mashtrime t'u njihet leje qëndrimi për mbrojtje sociale (e njëjta që ligji u njih viktimitave të prostitucionit apo të kaporalatit), për pritje punësimi apo për motive humanitare. Por mbi të gjitha, shoqata kërkon një reformim radikal të ligjit të tanishëm të imigracionit që t'i përgjigjet realitetit.

"Sugjerojmë - përfundon presidenti i NAGA-s - të nisim nga këto tre propozime: të ndahet hyrja e punonjësve në Itali nga kriteri i pasjes së vendit të punës; të parashikohet me ligj mundësia e legalizimit për ata që ndodhen në Itali e që kanë një vend pune; të parashikohet mundësia e ardhjes në Itali për kërkim pune".

Me një fjalë të zgjerohen kanalet e imigracionit të rregullt në Itali, në mënyrë që të goditen ata që spekulojnë me klandestinët.

Elvio Pasca

Postat Italiane nxjerrin në shitje apartamentet por jo për emigrantët

Shoqëria Poste Italiane SpA merr prej emigrantëve 12,5 milionë euro në vit me mbledhjen e kërkesave për lejeqëndrimet, por tani që nxjerr në ankand disa apartamente që ka në pronësi, i përjashton ata nga mundësia e blerjes. Unar "I pajustificueshëm kriteri i shtetësisë". Por Poste Italiane nuk tërhiqet: "E parashikon ligji, imigrantët mund të marrin pjesë në ankand kur të bëhen italianë"

pozicion të publikut, përfshirë mundësinë e pjesëmarrjes në procedurat për marrjen e strehimeve të ndërtimeve rezidenciale publike...".

Ndërhyrjen e Unar-it e kërkuan Asgi, Shoqata e Studimeve juridike mbi imigracionin dhe Cgil e Brescias përmes Fondacionit Guido Piccini. Për arsyen e mësipërme, vinin në dukje ata. Pra që Teksti unik për imigracionin thotë shprehimisht që imigrantët e rregullt e kartë qëndrimi apo lejeqëndrim dyvjeçar kanë të drejtë të barabarta me italianët lidhur me shtëpitë popullore.

Pikërisht kësaj norme i referohet edhe gjykimi i nënshkruar më 4 korrik nga këshilltarja e Unar-it Oriana Calabresi. Sipas ekspertës, lajmërimi i Postës "mund të konsiderohet akt me përmbajtje diskriminuese" (pra të paligjshme), mungon "një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm" për futjen e kriterit të shtetësisë italiane, si edhe "një raport i drejtë mes objektivit dhe mjeteve të përdorura".

Clabresi kujton se diskriminime të këtij lloji, që lidhen me mundësinë e

marrjes së shtëpisë, "nuk janë raste të rralla" dhe merr si shembull komunën e Milanos, që u jepte më shumë pikë italiane se të huajve në mënyrë që të parët të renditeshin më lart në listën e personave që mund të përfitonin një shtëpi, derisa gjykata e detyroi të bënte prapakthehu. "Ndaj këshillojmë Poste Italiane spa - përfundon ekspertja - t'u përshtatet parimeve të mos diskriminimit".

Do të marrë parasysh Posta këtë këshillë? Duket se jo, nga ç'lexohet në mesazhin që i ka nisur redaksisë së Stranieriinitalia.it.

"Kriteri i shtetësisë italiane - thotë mesazhi - përcaktohet me ligj dhe kërkohet nga të gjitha entet që shesin banesa të ndërtimeve rezidenciale shtetërore". "Poste Italiane spa - shton - respektom nomat në fuqi gjatë shitjes së pronave të veta të patundshme", për të përfunduar me një saktësim, që të befason e të lë shije të hidhur: "Imigranti me shtetësinë italiane do të mund të marrë pjesë lirish në ankandin për blerjen e banesave".

Katër i Radës, la nave della tragedia, è salva

Ci sono voluti quattordici anni e tre mesi d'attesa per ottenere finalmente la sentenza sull'affondamento della Katër i Radës, decisa dalla Corte d'assise d'appello di Lecce, presieduta dal Giudice Roberto Tanisi: condanne ridotte, ma sostanzialmente confermate per i due presunti responsabili della "Strage del Venerdì Santo", l'italiano Fabrizio Laudadio, comandante della corvetta Sibilla della Marina Militare e l'albanese Namik Xhaferi, pilota della Katër.

Sentenza terminata, ma una questione altrettanto urgente restava irrisolta: la possibile restituzione di quella che fu una bara per centinaia di persone. La Corte aveva inizialmente disposto la revoca del provvedimento di restituzione della Katër i Radës e la rottamazione di quel che resta di essa, delegando per l'esecuzione il comando della Marina Militare di Brindisi.

Sulla vicenda è intervenuta la Presidente di Integra Onlus, la Dott.ssa Klodiana Çuka, esperto di politiche migratorie ed europee. Presidente di Integra, impegnata con l'Associazione da lei stessa fondata nel 2003, nella diretta di Tele Rama News andata in onda la mattina del sabato 2 Luglio - in compartecipazione telefonica con l'Avv. Francesca Conte, difensore delle famiglie delle vittime e il Giudice Roberto Tanisi, Presidente della Corte d'Appello di Lecce - aveva espresso tempestivamente il desiderio di occuparsi personalmente del recupero del relitto, qualora i tempi l'avessero consentito. Lunedì stesso dopo il fine settimana, Klodiana Çuka considerando l'instabilità politica albanese e il periodo estivo che avrebbero potuto provocare ulteriori lungaggini temporali, ha avviato la procedura di recupero del relitto partendo però con una telefonata e con una lettera indirizzata al Sindaco di Otranto, Luciano Caridi, e per conoscenza al Giudice Tanisi e all'Avv.ssa Conte: "Gent.mo, (...) in qualità di Presidente di Integra Onlus, ma anche di cittadina albanese, esperto in politiche migratorie ed europee, che ha iniziato ad operare come mediatrice linguistico culturale, che si spende ormai da anni per garantire l'integrazione dei cittadini albanesi attraverso un lavoro costante con le istituzioni, ritengo che abbattere il relitto della nave corrisponda ad una doppia uccisione della memoria collettiva di un popolo. (...) vista la sensibilità del popolo del Salento e di Otranto, in particolare, tanto da aver sfiorato il Premio Nobel per l'accoglienza, credo che non ci sarebbe posto migliore di Otranto stesso per elevare il relitto in

Grazie all'intervento di Klodiana Çuka e della sua associazione Integra Onlus, diventerà un monumento a Otranto



LA TRAGEDIA Correva l'anno 1997

La strage avvenne nel Canale d'Otranto, il 28 Marzo 1997: la nave militare italiana, la Sibilla, speronò in acque internazionali la Katër i Radës, provocandone l'affondamento con la morte di oltre cento persone, molte delle quali donne e bambini. Fuggivano tutti dalla guerra civile che era scoppiata in Albania contro il fallimento delle Piramidi finanziarie. Un viaggio costato circa 800mila lire a testa.

In quell'anno, da alcuni giorni, però, l'Italia aveva predisposto, in base anche a un accordo con l'Albania, un blocco navale, nome in codice "Operazione bandiere bianche", schierando diverse navi militari nel Canale d'Otranto con il compito di bloccare le cosiddette "carrette" del Paese delle aquile. La Sibilla era tra le navi italiane impegnate nel "blocco" deciso dal governo italiano in pieno accordo con quello albanese; un accordo, tra le altre cose, lesivo del diritto internazionale d'asilo. L'Italia infatti fu allora richiamata dall'Alto Commissariato delle Nazioni Unite per i Rifugiati (UNHCR).

Il trattato firmato tra l'Italia e l'Albania non prevedeva distinzioni sulle procedure da attuare in caso di attraversamenti non autorizzati del Canale d'Otranto, così, quando si trovò in mare aperto, il barcone fu avvicinato da 5 imbarcazioni della Marina italiana, che misero in atto le cosiddette manovre di allontanamento. La Sibilla, però, si avvicinò troppo, al punto da toccare la Katër i Radës, causandone l'affondamento. Furono 81 i corpi recuperati ad 800 metri di profondità, ma si calcola siano stati 108 i morti complessivi. La tragedia fu una delle conseguenze della politica dei respingimenti generalizzati inaugurata in quegli anni dal governo italiano. Quella stessa politica che ha trasformato il Mar Mediterraneo in uno dei più grandi cimiteri senza lapidi della storia recente (l'ONU denuncia che in 10 anni, sono state più di 10.000 le persone morte nel Mediterraneo nel tentativo di raggiungere l'Europa). La politica dei respingimenti, in aperta violazione con la Convenzione di Ginevra, nega il principio "non refoulement" che è uno dei principi cardine del diritto internazionale del rifugiato, ovvero: il divieto del respingimento dei migranti verso Paesi dove possono subire trattamenti inumani e degradanti.

monumento "alla memoria" delle tante vite ingoiate e sepolte in quel tratto di mare".

A distanza di una decina di giorni dall'accorato appello, è giunta alla Presidente di Integra la telefonata del Sindaco di Otranto che comunicava la sospensione dell'abbattimento. Il Sindaco Luciano Caridi dopo aver accolto con immediatezza e aperto spirito solidale la sua richiesta, a sua volta ha trasmesso ufficialmente la disponibilità di accogliere il relitto al Giudice Tanisi. La notizia ha suscitato la felicità partecipata di tutti i volontari e operatori di Integra, dell'Avv. Francesca Conte ma anche di tanti amici albanesi e italiani che avevano preso a cuore la salvezza della nave e che hanno seguito la faccenda costantemente in tutti questi anni.

Nella mattinata del 14 Luglio, la Presidente di Integra e il Sindaco Luciano Caridi hanno discusso in merito alle modalità di recupero e di trasporto della Katër i Radës, nella città di Otranto. L'intento Comune, in collaborazione con Integra Onlus è quello di rendere del relitto un vero e proprio monumento della memoria e dar vita ad un progetto permanente che richiamando un'azione di sensibilizzazione locale e degli artisti, locali ma anche esponenti del mondo artistico albanese, apra uno spaccato storico-culturale affinché la memoria della tragedia non si perda, ma permanga iscritta nel tempo, testimone di una pagine di storia che non sbiadirà mai.

Una grande vittoria, hanno esclamato in coro molti amici, quella della Presidente di Integra, come sempre pronta ad impegnarsi in prima persona e con la sua Associazione nella messa in atto di interventi degni di una tale commemorazione: un atto oltre che doveroso, di profondo valore etico e umano, di dissoluzione di ogni linguaggio xenofobo e razzista, nella speranza che tragedie simili non si ripetano più, in una società democratica che non può accettare che in nome della presunta sicurezza di un Paese, si innalzino barriere che impediscono ogni forma di accoglienza e che violano il diritto internazionale.

Per qualsiasi comunicazione, contributo, intervento che si voglia offrire a sostegno della vicenda sarà possibile contattare la Presidente di Integra Onlus, la Dott.ssa Klodiana Çuka, al seguente indirizzo e-mail: presidente@associazioneintegra.eu. Integra sta attivando anche il conto corrente dedicato al recupero del Relitto e la resa dello stesso in Monumento, andando incontro con i costi anche all'Amministrazione Comunale di Otranto, determinante in questa impresa inestimabile per il valore storico e umano.

“

La notizia ha suscitato la felicità partecipata di tutti i volontari e operatori di Integra, ma anche di tanti amici albanesi e italiani che hanno preso a cuore la salvezza della nave e che hanno seguito la faccenda costantemente in tutti questi anni

“

L'intento è quello di rendere del relitto un vero e proprio monumento della memoria che apra uno spaccato storico-culturale affinché la memoria della tragedia non si perda, ma permanga testimone di una pagine di storia che non sbiadirà mai



Risparmio per eni



po mendon për mirëmbajtjen e klimatizatorit?



me programin "**programma energia casa**" të kesh klimatizatorin efikas dhe të pastër, nga sot është akoma më e thjeshtë. Pranë pikëshitjeve **energy store eni** mund të sigurosh:

- mirëmbajtje të programuar të ndjekur nga teknikë të specializuar
- shërbim asistence të shpejtë me ardhjen në shtëpi të një tekniku brenda 48 orëve nga telefonimi

Për më tepër, duke zgjedhur paketën e re relax superSemplice të eni gaz dhe ditë brenda 14/07/2011, mund të kesh me koston e vetëm tre kalëve në muaj mirëmbajtjen vjetore të programuar të klimatozatorit*.
*Për kosto "non standard" dhe shërbime të tjera të kësaj lloji, kontaktoni numrin 800 98 78 98 ose shko në energystore.eni.com

energy store



na telefono në **800 98 78 98**
ose shko në **energystore.eni.com**

eni

rrjet në franchising eni

LIBERALIZIMI I VIZAVE**Ku do të mblidhen familjet shqiptare këtë verë?**

Sipas ekspertit të turizmit në Durrës, një pjesë e familjeve bashkohen për të kaluar pushimet edhe në vende të ndryshme të Evropës, ku të afërmit e tyre jetojnë dhe punojnë prej vitesh. Por gjithsesi porti i Durrësit shënon një rritje të ndjeshme të ardhjeve të emigrantëve

Pushimet e familjeve shqiptare kanë ndryshuar pas liberalizimit të vizave në vendet Shengen nga 15 dhjetori i vitit të kaluar. Nëse deri vjet, vera ishte periudha e bashkimit të familjeve në Shqipëri me bijtë që ktheheshin emigracioni për ndonjë javë pushime në gjirin familjar, sot nuk ndodh gjithnjë kështu. Sipas Edmond Bashos, ekspert i turizmit në qytetin e Durrësit, tashmë një pjesë e familjeve bashkohen për të kaluar pushimet edhe në vende të ndryshme të Evropës, ku të afërmit e tyre jetojnë dhe punojnë prej vitesh.

Ai thotë për ATSh-në se, "në prag të pushimeve të para verore pas ngjarjes së rëndësishme të lëvizjes së lirë të shqiptarëve në vendet e Evropës Perëndimore është vënë re një ndryshim i kahut së udhëtimeve për t'u bashkuar me familjet përkatëse".

"Grupe familjesh prenotojnë udhëtime drejt destinacioneve të ndryshme turistike në Itali, Spanjë e Greqi, duke shfrytëzuar mundësinë e udhëtimit pa viza në kufirin me vendet përkatëse", thekson Basho duke shtuar se gjatë këtij viti numri i udhëtarëve, që lëvizin për turizëm është rritur me rreth 10%, duke përfshirë edhe ata që i drejtohen vendit tonë për vizita turistike. Turizmi shqiptar me grupe drejt vendeve të tjera është zhvendosur kryesisht në shtator, kur ofertat turistike drejt plazheve të Turqisë apo në Palma de Majorca (Spanjë) kanë çmime më të ulëta.

E megjithatë, fluksi i emigrantëve në hyrje ka nisur të rritet: mbi 14 mijë udhëtarë me 3.500 automjete kanë mbërritur me 18 tragete dhe katamaranë në portin detar të Durrësit, vetëm fundjavën e dytë të korrikut.

Shqiptarët pa viza edhe në Serbi

Shqipëria dhe Serbia nënshkruan më 5 korrik marrëveshjen dypalëshe "Mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve"

Zyra e shtypit e MPJ-së bën të ditur se, në ambientet e kësaj ministrie u nënshkrua marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë "Mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve". Kjo marrëveshje u nënshkrua, për palën shqiptare nga zëvendësministri i Jashtëm, Selim Belortaja, ndërsa për palën serbe nga Ambasadori i Republikës së Serbisë në Tiranë, Miroljub Zaric.

Marrëveshja për lëvizjen e lirë bazohet në parimet e reciprocitetit të plotë midis dy shteteve, vullnetit të mirë e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe synon mundësimin e qarkullimit të lirë të qytetarëve nga njëri shtet në tjetrin.

Ajo parashikon përjashtimin nga viza për hyrjen në territorin e secilës palë për një vizitë ose qëndrim që nuk i kalon 90 ditë brenda 180 ditëve. Për qëndrimet afatgjata në territorin e shtetit fqinj, për qëllime studiimi, punësimi, ribashkimi familjar, etj, shtetasit do t'u nënshtruhet kriterëve të legjislacionit të brendshëm të secilit vend.

Në barin e Dardan Islamit në Drimadhes janë të shumtë ata që diskutojnë nëse pushimet në jug të Shqipërisë janë zgjedhja e duhur. Ata nga Tirana, por edhe ata nga Prishtina thonë se nga viti në vit jugu po ndryshon për keq. Të parët, nostalgjikë për vitet e dikurshme, ndihen të çorientuar nga kaosi i ndërtimeve dhe makinat e shumta që parkohen deri në breg të detit. Për të dytët, zbulimi i ujrave të tejudkshme të Dhermiut, emocioni i turizmit "kuq e zi" dhe entuziazmi i rrugës së re që mbizotëronin deri dje ndaj pakënaqësive të rastit, sot ia ka lënë vendin mendimit se kjo pjesë e Shqipërisë nuk ofron një raport të drejtë cilësi-çmim. Jugu është i shtrenjtë, me shërbim të dobët, kushte mesatare pushimi, infrastrukturë kaotike dhe në rrezik degradimi të mëtejshëm nëse nuk vihet dorë. Debatit rreth një shkrimi të fundit të New York Times për jugun dhe asaj që secili përjeton atje, çon tek pyetja se a ia vlen ende të kalohen pushimet në Shqipëri? A mjafton ekzotizmi dhe pastërtia e ujit për të pushuar pas një viti punë?

Kohët e fundit turizmi shqiptar është rikthyer në vëmendjen e mediave botërore. New York Times, Financial Times, The Guardian, guida e famshme Lonely Planet dhe shumë portale të rëndësishme, po e paraqesin Shqipërinë si një nga vendet më tërheqëse për turizëm. Ushqimi, mikëpritja, ujërat e Jonit, çmimet e arsyeshme dhe pozita gjeografike janë disa prej elementëve që përbëjnë atraksionin shqiptar. Në udhëtimin e shkurtër nëpër Shqipëri, një gazetar i huaj vërtet që mund t'ia kalojë mirë veçanërisht nëse ka gjetur edhe shoqëruetin e duhur

Turizmi që mashtron

Nga Armand SHKULLAKU

Ushqimi, mikëpritja, ujërat e Jonit, çmimet e arsyeshme dhe pozita gjeografike janë disa prej elementëve që përbëjnë atraksionin shqiptar. I huaji mund të shijojë kënaqësitë e një turi bregdetar, të provojë peshkun e freskët, të kthejë ndonjë gotë tek Havana apo Lolly Pop apo të habitet duke parë një gomar të vërtetë që shërben ende si mjet transporti. Por ama gjithçka mbyllet këtu.

lokal. Ai mund të shijojë kënaqësitë e një turi bregdetar, të provojë peshkun e freskët, të kthejë ndonjë gotë tek Havana apo Lolly Pop apo të habitet duke parë një gomar të vërtetë që shërben ende si mjet transporti. Këta elementë i bëjnë rrëfimet për bregdetin shqiptar tërheqëse dhe ekzotike: një vend i vrigjër dhe kaq afër për t'u vizituar. Por ama gjithçka mbyllet këtu.

Në pamje të parë një paraqitje e tillë e turizmit shqiptar është pozitive. Është një reklamë e mirë falas për një vend që krizat politike i janë shndërruar në menstruacione. Shqipëria ka nevojë të prodhojë diçka të mirë dhe këtë mundësi po ia jep natyra dhe pozita e saj gjeografike. Por ky reklamim thuhet sipërfaqësor i mediave të mëdha botërore për turizmin

shqiptar ka dhe anën e tij negative. Së pari ai po u shërben autoriteteve për të mbuluar punën e dobët në turizëm. Reportazhet e gazetarëve të huaj po përdoren si dëshmi të Shqipërisë që ka ndryshuar, ndërkohë që gjendja e bregdetit (flasim për jugun se Durrësi nuk ka më shpresë) po shkon drejt rrënimin: betonizim dhe ndërtime pa rregull, ndotje e ujrave, tonelata mbeturina, godina të ish kampeve socialiste të mbetura si fantazma, shërbime sociale thuhet inekzistente. Qeveria mburret për rrugët, por ndërkohë nuk ka bërë thuhet asgjë për të rritur cilësinë e pushimit në jug të vendit. Së dyti, duke përballur ndikimin e këtyre mediave dhe guidave prestigjioze në orientimin e turistëve dhe mundësitë reale që ka Shqipëria, turizmi shqiptar mund të rezul-

Tetë kështjellat “e fshehura” të Vlorës

Specialisti i monumenteve të kulturës, Novruz Bajrami: “miradministrimi i tetë kështjellave të rajonit të Vlorës mund të krijojë të ardhura të konsiderueshme, dhe të ndikojë në ndërtimin e një imazhi të qëndrueshëm tek turistët e huaj”

Tetë kështjella të ndërtuara në rajonin e Vlorës dhe që përfaqësojnë periudha të ndryshme historike, vlerësohen si objekte të rëndësishme në funksion të zhvillimit të turizmit në këtë rajon bregdetar. Specialisti i monumenteve të kulturës, Novruz Bajrami, thotë për ATSh-në se “miradministrimi i tyre mund të krijojë të ardhura të konsiderueshme, por njëkohësisht ndikon në ndërtimin e një imazhi të qëndrueshëm tek turistët e huaj”.

Sipas tij, ndër kështjellat më të spikatura është kalaja e





tojnë një zhgënjim. Në reportazhet e shtypit të huaj flitet për plazhin e Gjipesë por nuk thuhet se në Shqipëri nuk gjenden hotele apo resorte të kapaciteteve të nevojshme për të përballuar një fluks të madh turistik. Se shërbimet e domosdoshme, duke filluar nga ai mjeksor e deri tek ato argëtuese, po ndikojnë dita-ditës që turizmi të shkojë drejt atij ditor dhe jo javor apo më gjatë.

Mbi të gjitha, gazetarët e huaj, të befashuar nga një vend që e zbulojnë për herë të parë dhe të kufizuar në kohë, nuk arrijnë në brendësi të problemit kryesor të turizmit shqiptar. Niveli i dobët dhe kultura mediokre e operatorëve turistikë të jugut së bashku me indiferencën e qeverisë po e kthen në zhgënjim rrëfimin për bregdetin magjik të Jonit



Mbi të gjitha, gazetarët e huaj, të befashuar nga një vend që e zbulojnë për herë të parë dhe të kufizuar në kohë, nuk arrijnë në brendësi të problemit kryesor të turizmit shqiptar. Niveli i dobët dhe kultura mediokre e operatorëve turistikë të jugut së bashku me indiferencën e qeverisë po e kthen në zhgënjim rrëfimin për bregdetin magjik të Jonit

Vlorës, e ndërtuar në vitin 1531 nga Sulltan Sulejmani, gjurmë të të cilës janë zbuluar në afërsi të Skelës. Qëllimi i ngritjes së saj, sipas historikanëve, ishte mbrojtja e gjirit të Vlorës nga sulmet e venedikasve.

Krahas saj, në listën e kështjellave përfshihet edhe ajo e Gjon Boçarit, e cila ndodhet në fshatin Tragjas dhe është ndërtuar në periudhën mes shekujve XVI-XVII. Ajo ka formë drejtkëndore dhe gjerësia e mureve arrin deri në 1.25 metra dhe lartësi deri në 5.5 metra.

Ndërsa kalaja e Himarës i përket një periudhe shumë më të hershme. E ndërtuar si një fortifikim i fisit të Kaonëve, ajo përmendet shpesh në dokumentet bizantine. "Në shekullin VI kalaja u riparua me urdhër të Perandorit Justinian, për t'u bërë ballë sulmeve të barbarëve, gotëve e husëve", sqaron Bajrami.

Pak kilometra nga qyteti i Himarës, ndodhet dhe kështjella e Porto Palermos, ose e njohur ndryshe kalaja e Ali Pashë Tepelenës. Ajo u ndërtua në fillim të shekullit XIX nga pashai i famshëm, si një dhuratë për

zonjën e vet, Vasiliqinë. Kalaja u projektua nga një inxhinier francez në formën e një pesëkëndëshi, me muret që arrijnë një trashësi prej 1,6 metra dhe u ndërtua nga specialistë italianë dhe shqiptarë. Ky objekt i trashëgimisë kulturore ruhet në një gjendje mjaft të mirë dhe është shndërruar prej disa vjetësh në një qendër mjaft të rëndësishme, që ka tërhequr vëmendjen e vizitorëve shqiptarë dhe të huaj.

Në listën e tetë kalave me vlera në rrethin e Vlorës përfshihet dhe ajo e Kaninës. E ndërtuar mbi një qendër të vjetër banimi, në shekullin III



Kalaja e Vlorës, kështjella e Gjon Boçarit, kalaja e Himarës, kalaja e Ali Pashë Tepelenës, kalaja e Kaninës, Kalaja e Mavrovës, kështjella e Kukumit, kalaja e Kropishtit janë të gjitha në rrethin e Vlorës, të ngritura në epokë të ndryshme historike

Jonit. Kushtet e hoteleve në jug janë tepër larg nga standarti i çmimeve që ofrojnë. Ushqimi, me përjashtime të rralla, është i keq dhe i shtrenjtë në mënyrë të paarsyeshme. Shërbimi, të cilin e kanë vuajtur të gjithë ata që për të porositur një kafe kanë provuar limitet e durimit të tyre, është i aftë që në disa orë t'i shndërronë pushimet në zborr. Të shtyrë vetëm nga fitimi dhe pa ndonjë strategji për ta zhvilluar e shtrirë në kohë biznesin e tyre, tregtarët dhe biznesmenët atje kërkojnë që në dy muaj të fitojnë sa për 1 vit. Ata kënaqen kur klienti nuk e kupton që peshku nuk është i freskët, që mjalti është i përzier me sheqer apo pijet janë fallco, duke mos kuptuar që duke abuzuar me besimin e njerëzve po sharrojnë degën ku qëndrojnë vetë. Në 20 vitet e fundit, investimet serioze në jug të vendit mund të numërohen me gishtat e njëres dorë. Madje dhe ato më të thjeshtat, që na bëjnë përshtypje kur udhëtojmë jashtë, ku një shtëpi, një fermë apo një kantinë prodhojnë vajin e vet, verën, mjaltin, djathin, etj. Jo, në jug të Shqipërisë gjen vetëm teza të dyshimta dhe spekulantë që mezi presin të ta hedhin. Ky është në fakt realiteti i rivierës shqiptare sot, produkt i impotencës së shtetit dhe injorancës së individit.

Nëse nuk bëhet një plan kombëtar për ta shpëtuar ende sa ka kohë pjesën më të bukur të natyrës shqiptare, shkrimet e New York Times dhe këshillat e Lonely Planet do të mbeten një reklamë për një produkt kallp që do t'i zhgënjëjë edhe turistët e huaj. Sa për ata shqiptarë, jugu është kthyer më shumë në inerci se sa në kënaqësi të vërtetë. Tek bari i Dardanit diskutimet do të vazhdojnë edhe këtë verë...

Turqia mbetet vendi i preferuar për shqiptarët

Ku i kalojnë pushimet shqiptarët? Në Shqipëri apo jashtë saj?

Në këto ditë të nxehta vere të gjithë mendojnë vetëm për pushime, kryesisht për të qenë sa më pranë detit. Janë ditët e fundit të qershorit dhe ka nga ata që i kanë planifikuar pushimet e tyre, por të shumtë janë edhe ata që vendosin në çastin e fundit.

Me ardhjen e verës, pyetja e parë që bëjnë të gjithë është: "pushime në Shqipëri apo jashtë saj?". Dhe sigurisht që përgjigjja varet nga mundësitë ekonomike, por nuk është çudi që pushimet jashtë vendit të shkojnë më lirë se në një vend në jug të Shqipërisë.

Sipas disa agjencive turistike në Tiranë, në të cilat prenotimet kanë nisur që në fillim të qershorit, edhe këtë vit vendin e parë e mban Turqia. Me gjithë liberalizimin e vizave, ajo mbetet destinacioni ku preferojnë të shkojnë më shumë shqiptarët. Qytetet si Antalia, Kemer, Belek, Alania prej vitesh zgjidhen nga shqiptarët për pushimet



verore, jo vetëm për resortet e mëdha me shumë shërbime, por edhe falë mungesës së vizave.

Resortet me gjithçka të përfshirë brenda çmimit, me mundësi të ndryshme argëtimi për të gjitha moshat, udhëtimi edhe me fluturime charter, afërsia e hoteleve me detin e bëjnë Turqinë një vend të përshtatshëm ku paketat 10 ditore nisin nga 600 euro personi. Por në zgjedhjen prej vitesh të Turqisë për pushime nuk përjashtohet edhe faktori i përshtatjes së turistëve shqiptarë me mentalitetin e banorëve në qytetet pritëse. Heqja e vizave duket se nuk ka mundur të ulë numrin e turistëve drejt Turqisë, e cila konkurren në treg me ofertat e saj më të leverdishme në krahasime me çmimet e larta të Europës.

Por heqja e vizave ka ndikuar në zgjedhjet që shqiptarët bëjnë për pushimet e tyre, duke renditur pas Turqisë, Greqinë dhe Spanjën. Rritja e kërkesës për këto dy vende ka bërë që disa agjenci udhëtimi të shtojnë edhe fluturime charter për disa nga ishujt e këtyre vendeve.

Por, ka edhe një pjesë qytetarësh, të cilët, për t'i mbetur besnik vendit të tyre, apo për pamundësi ekonomike zgjedhin bregdetin shqiptar për të kaluar pushimet e tyre. Pjesa më e madhe zgjedhin pushimet në jug të Shqipërisë, ku vendin e parë e mbajnë Vlora dhe Saranda.

Ndërsa zonat bregdetare si: Jala, Dhërmiu, Llamani vazhdojnë të mbeten të populluara nga të rinjtë, pasi dhe lokalet e natës së kryeqytetit shpërngulen në këto vende.

Sipas agjencive turistike në Tiranë, shqiptarët zgjedhin edhe zonat bregdetare fqinje në Mal të Zi, apo Kroaci, por qëndrimet në këto zona janë të shkurtra, kryesisht në fundjavë. Prenotimet arrijnë maksimumin e tyre gjatë muajit gusht, kryesisht në pesëmbëdhjetëditëshin e parë, kur Tirana boshatiset dhe të gjithë i drejtohen bregdetit.

Edhe pse agjencitë turistike fillojnë ofertat e verës që në muajin mars, sipas tyre, shqiptarët kryesisht vendosin minutën e fundit dhe të rrallë janë ata që prenotojnë disa muaj më parë.

STUDENTËT - MBYLLEN PARAREGJISTRIMET

Në fund të gushtit vizat e hyrjes

Mbyllet pararegjistrimet në universitetet italiane për studentët jekomunitarë që jetojnë jashtë Italisë. Në shumë konsullata nuk pranohen më kërkesa, të tjera do të vazhdojnë ta bëjnë edhe për pak ditë. Në Tiranë, Ambasada italiane ka pranuar kërkesat deri më 20 qershor.

Të gjitha përfaqësitë diplomatike duhet të kenë një kuadër të qartë të situatës deri në mes të korrikut, për t'ia përcjellë kërkesat universiteteve. Studentëve të ardhshëm nuk u mbetet veçse të presin, vetëm në gusht do të mësojnë nëse do të mund të vijnë në Itali e të kalojnë provimin e parë, atë të gjuhës apo edhe ndonjë tjetër për fakultetet me numër të mbyllur.

Kalendari i përgatitur nga ministria e Universitetit, në bashkëpunim me ministrinë e brendshme dhe të Jashtme, parashikon që vizat e hyrjes të lëshohen brenda 24 gushtit. Kjo gjë, sipas atyre që kanë përcaktuar afatin, duhet t'u lejojë të

Konsullatat do t'u përcjellin kërkesat universiteteve, më pas do të thonë kush mund të vijë në Itali. Nikaj e ASUF-it: "Ka shumë pak kohë, pak informacione dhe kur mbërrimë në Itali ndihemi të braktisur



gjithë studentëve të jenë në Itali brenda 1 shtatorit, datë kur parashikohet të mbahet provimi i gjuhës italiane.

"Koha është e pakët, praktikisht sot të

japin vizën, nesër duhet të nisesh. Nuk ke kohë as të organizohesh e shpesh arrihet vonë, kur provimi është dhënë apo kur kanë skaduar afatet për të kërkuar

bursën e studimit" thotë Arta Nikaj, kryetare e shoqatës së studentëve shqiptarë të Firencës, ASUF.

Nikaj ka ardhur në Itali në vitin 2003, pikërisht duke ndjekur rrugën e pararegjistrimit. "Në krahasim me vitet e shkuara - tregon - situata është përmirësuar disi, por ende ka mangësi informacioni për çdo hap të procedurës. U besojmë fjalëve të njëri-tjetrit, të bazuara në ato pak lajme që dalin nga konsullata italiane. Shpesh çojmë në konsullatë vetëm një pjesë të dokumenteve e zbulojmë që nevojiten të tjerë. Është një vajtje-ardhje e vazhdueshme".

E kur mbërrihet në Itali, gjendja nuk përmirësohet. "Studentët e huaj braktisen, mbeten si peshku pa ujë, nuk dinë kujt t'i drejtohen e si të veprojnë. Mbështeten tek miqtë e të afërmit, deri sa gjejnë një dhomë me qira. Zakonisht ia dalin të marrin një dhomë në konvikt vetëm nga viti i dytë" vazhdon të shpjegojë Nikaj.

Ndoshta edhe për shkak të vështirësive të tilla, Italia tërheq shumë më pak studentë të huaj se vendet e tjera të industrializuara. Përbëjnë vetëm 3% të të regjistruarve, ndërsa mesatarja e vendeve të OSBE-së është rreth 8,5%.

Elvio Pasca

Në Romë tërhiqen pasaportat për të cilat është aplikuar deri në mes të qershorit

Pas rreth një muaji që nuk silleshin pasaporta të reja, mbërrijnë më në fund rreth 450 copë. Mbetet sidoqoftë i pazgjidhur problemi i transportit nga Tirana në Romë, që mund të shkaktojë sërish vonesa të pasaportave të reja

Zyra konsullore e Ambasadës

shqiptare në Romë ka tërhequr më 4 korrik rreth 450 pasaporta të gatshme e ka nisur shpërndarjen e tyre. Kështu që tashmë mund të tërhiqen edhe në Romë pasaportat për të cilat është aplikuar deri në mes të qershorit. Por gjithsesi, burime nga ambasada bëjnë të ditur që problemi i transportit të pasaportave të gatshme nga Tirana në Romë ende nuk është zgjidhur përfundimisht, gjë që do të thotë se vonesat në dorëzimin e tyre mund të përsëriten në të ardhmen edhe pse ato janë gati brenda pak ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Në shqiptariitalse.com mund të shihni listën e pasaportave të patërhequra ende nga të interesuarit, listë që do të gjeni gjithnjë të përditësuar në faqet tona internet dhe në ato të Ambasadës.

Pikërisht për tërheqjen e dokumenteve, konsujt në Romë këshillojnë me forcë që para se të shkohet në Ambasadë është mirë të pyetet në numrin e celularit të vënë në dispozicion për informacione (0039)342.364.0798 apo të konsultohen faqet internet ku botohet lista e pasaportave të gatshme. Të gjithë qytetarët që kanë aplikuar për pasaportë biometrike dhe letërnjoftim elektronik, pranë Ambasadës së Shqipërisë



në Romë, mund të paraqiten për t'i tërhequr ato në oraret 13:00 - 15:00 nga e hëna deri të premtën.

Për tërheqjen duhet të paraqiten me një dokument identiteti me foto dhe me faturën e aplikimit.

Tërheqja e letërnjoftimit bëhet vetëm në praninë e person-

it që ka aplikuar, ndërsa për fëmijët pasaporta mund të tërhiqet edhe nga prindi, pa praninë e fëmijës duke pasur me vete një dokument që vërteton lidhjen familjare me fëmijën.

Ndërsa Konsullata e përgjithshme e Shqipërisë në Milano, lajmëron në faqen e saj të internetit se të gjithë qytetarët shqiptarë që kanë aplikuar për dokumentet pranë kësaj konsullate nga 28 prilli deri më 17 qershor, mund të paraqiten pranë saj për t'i tërhequr. Natyrisht, nëse nuk e kanë bërë deri më sot.

Sipas lajmërimit on-line të Konsullatës, tërheqja bëhet nga ora 12:00 deri në orën 14:00, nga e hëna në të premtë, duke paraqitur faturën e aplikimit dhe një dokument identifikimi. Nëse pasaporta mund të tërhiqet edhe nga një familjar (me faturën e aplikimit), kush ka paraqitur kërkesë edhe për letërnjoftimin elektronik, duhet të paraqitet personalisht në konsullatë.

VIZAT ITALIANE PËR QËNDRIME TË GJATA

Të vish në Itali kushton më shtrenjtë

Nga 1 korriku ka shkuar në 105 euro tarifa për vizat afatgjata, të domosdoshme për të ardhur në Itali për punë apo për bashkim familjar. Çmimi edhe më i lartë nëse përdoren agjencitë e jashtme tek të cilat mbështeten konsullatat

Të vish në Itali për turizëm, tashmë pa viza nuk kushton asgjë, por për të qëndruar mbi 90 ditë çmimet e vizave janë rritur.

Në fakt, nga 1 korriku 2011, tarifa e "vizave kombëtare për qëndrime afatgjata" është rritur nga 90 në 105 euro, që u paguhen konsullatave italiane në çastin e paraqitjes së kërkesës së vizës. Është "dhuratë" e dytë ligjit nr. 30/2010 të 5 marsit 2010 (neni 4 paragrafi 4), që një vit më parë i rriti çmimet e këtyre vizave nga 75 në 90 euro.

Këto viza janë të domosdoshme për të gjithë ata që do të qëndrojnë në Itali për më shumë se tre vjet, pra edhe për shqiptarët për të cilët me liberalizimin e

vizave nuk kanë nevojë për to vetëm për qëndrimet deri në 90 ditë. Vizat për qëndrimet afatgjata lëshohen për shembull personave që vijnë në Itali për bashkim familjar apo me flukset e hyrjeve për punë.

Edhe duke lënë mënjanë çmimin e vizave, shpenzimi për të ardhur në Itali është rritur ndjeshëm edhe për faktin që gjithnjë e më shumë konsullata, gjithnjë me personel e instrumente të pamjaftueshme, mbështeten në agjenci private. Shpesh, pranë këtyre agjencive paraqiten kërkesat, merren takimet në konsullatë apo tërhiqen okumentet, natyrisht duke paguar për shërbimin e ofruar. EP

ZYRË SHËRBIMESH, KONSULENCE DHE PËRKTHIMESH

Përkthime të Autorizuara me Apostille nga Italia ose Shqipëria të Certifikatave të Lindjes për regjistrimin e fëmijëve në Zyrat e Gjendjes Civile në Shqipëri, të Certifikatave Familjare, Martesore, Penale për shtetësinë italiane, Përkthime Prokurash Speciale, Diplomash, Konvertime Patentash, Nulla osta për martesë, Informacione nga interneti mbi pasaportat biometrike, Viza pranë Ambasadave të ndryshme, etj. Dokumentet nisen me postë dhe brenda pak ditësh Ju arrijnë në adresën që dëshironi. Cell. 327.8848348



One Nation You&Me

Ti dhe vendi yt më pranë se kurrë

Mund të telefonosh në Shqipëri, në numrin Vodafone që preferon, me vetëm **1 cent** në minutë.

Pa impuls në përgjigje dhe pa kufizim.

Eja në një dyqan Vodafone ose telefono në numrin 42942.

Sepse i rëndësishmi je ti.

power to you



FUTBOLL, SERIA A

Dy lojtarë jokomunitarë për skuadër

Figc ngre kufirin e futbollistëve jokomunitarë që mund të luajnë në një skuadër të Serisë A. Kush vjen nga jashtë duhet të zëvendësojë futbollistë të cilëve po u skadon kontrata apo që po largohen nga Italia. Kuota për lojtarë vendas në çdo skuadër për të mbrojtur fidanishtet italiane

Vendoset sërish që në skuadrat e futbollit të serisë A të mund të luajnë deri dy lojtarë jokomunitarë, por klubet duhet të rezervojnë kuota për lojtarë që vijnë nga të ashtuquajturat "fidanishte" kombëtare.

Është ky kompromisi i vendosur dje nga Federata e Futbollit, Figc, e cila pranoi kështu nxitjen e presionin e Ligës A, që bashkon klubet e futbollit të kategorisë më të lartë. Nga sezoni i ardhshëm, ato mund të anëtarësojnë dy lojtarë jokomunitarë të ardhur nga jashtë, me kusht që të zëvendësojnë po aq lojtarë jokomunitarë me kontratat në skadim ose që transferohen jashtë Italisë.

Ardhja e shumë lojtarëve të huaj nga jashtë Italisë mund të dëmtojë "fidanishtet". Prandaj Federata e Futbollit i detyron skuadra e serisë A që të kenë në gjirin e tyre një kuotë të caktuar lojtarësh vendas, ata në moshën 15 deri 21 vjeç që janë të anëtarësuar në një klub në Itali prej të paktën tre sezonesh. Nëse për shembull skuadra a parë përbëhet nga 25 lojtarë, 8 duhet të jenë vendas.

"Vendosëm unanimisht mbi një problem strategjik për futbollin italian. Është një normë në përputhje me ato të 2009 dhe 2010, por me disa ndryshime", deklaroi Abete, duke specifikuar se "u munduam të evitojmë që të rinjtë që bëhen profesionistë, të përdoren për zëvendësimin e një jokomunitari. Kjo është një normë garancie. Jemi brenda kuotave të përcaktuara nga Coni që përcakton se numri maksimal i kontratave të reja për jokomunitarët duhet të jetë 60".

I kënaqur presidenti i Ligës së serisë A, Maurizio Beretta: "Kthimi i dy jokomunitarëve sjell për futbollin italian një rimëkëmbje të rëndësishme të aftësisë konkurruese për ekipet e Serisë A. Në këtë çështje ka pasur një sintoni mes të gjitha ligave A, B, Liga Pro dhe amatorët". Edhe sipas pronarit të Lazios Claudio Lotito, "vendimi i marrë është në interes të sistemit të dhe do të shërbejë për të sjellë në Itali lojtarët më të mirë".

Vendimin e djeshëm do të ndjehet menjëherë në tregun e transferimeve. Ai mund të zhbllokojë sjelljen tek Juventusi të brazilianit Bastos del Lione ose atë të bashkatdhetarëve të tij Ganso dhe Danilo Santos tek Milani.

Elvio Pasca

LORIK CANA

një tjetër shqiptonjë në stadiumin Olimpik

Futbollisti kosovar Cana ka nënshkruar me Lazion një kontratë 5-vjeçare. "Luftëtari" apo "shkatërrimtari", siç e thërrasin tifozët, dallohet edhe jashtë fushës së gjelbër. Prej kohësh është ambasador i Unicef-it dhe i Pnud-it, testimonial në Shqipëri i "Alo 116"-Linja Kombëtare e Telefonit të Ndihmës për Fëmijët. Lojtari më i shtrenjtë shqiptar i të gjitha kohërave i ka dhënë mbështetje Shqipërisë dhe Kosovës edhe në çastet e vështira. E nuk ishte e papritur që pas ndeshjes Shqipëri Biellorusi të kohëve të fundit, ndezi tifozët kuq e zi duke thirrur: "Thuajuni të gjithëve nuk ndërrohet kombësia... Nuk shitet shqiptaria...".

Daje Lorike! Që e përkthyer në shqipe të rrjedhshme duhet të jetë: Jepi Lorik! Është kjo fraza që haset më shpesh mes tifozëve të Lazios të cilët mezi po presin zbritjen në fushën e gjelbër të kapitenit të kombëtares shqiptare Lorik Cana. Ditët e para të korrikut ai nënshkroi një kontratë pesë-vjeçare me skuadrën bardhekaltër të kryeqytetit. Tanimë detajet e kësaj kontrate janë të njohura: futbollisti shqiptar ka nënshkruar për një shumë prej 1,7 milionë eurosh për sezon, gjithsej rreth 800 mijë euro më pak se sa merrte tek Galatasaraj, diferencë kjo që nuk e ka penguar të realizojë dëshirën e tij për të luajtur në serinë A italiane.

Nuk do jetë e vështirë për futbollistin shqiptar, i thirrur nga tifozët "luftëtar" ose "shkatërrimtar" që t'u fitojë zemrat tifozëve të Lazios. Koincidenca e simbolit të klubit (një shqiptonjë) me prejardhjen e Canës, duket sikur është një element më shumë që e afron atë menjëherë me sportdashësit. Jo rastësisht filluan të qarkullojnë shpejt frazat "Dy shqiptonja në qiellin e Romës", "Një tjetër shqiptonjë në

fushën e stadiumit Olimpik" dhe natyrisht ai shihet si kundërshtari ideal kundër kapitenit të Romës, Francesco Totti.

Sapo mbërriti në Romë e më pas kur filloi stërvitjen me skuadrën e Lazios në ditët e para të korrikut, Lorik Cana duket se gjeti menjëherë komunikimin dhe afinitetin me tifozët. Madje në Auronzo di Cadore, në Veneto, ku skuadra po stërvitet, kanë shkuar posaçërisht për ta takuar edhe familje e tifozë shqiptarë, krenarë për kampionin e tyre.

Lorik Cana ka lindur në Kosovë dhe që i vogël është larguar me familjen drejt Zvicërës. Që në moshën 16-vjeçare ka filluar të luajë me klubin e Lozanës e më pas ka kaluar me Paris Saint-Germain (69 ndeshje e 2 gola). Në vitin 2005 është larguar drejt klubit jugor Francez Olympique de Marseille ku kthehet në një ikonë të vërtetë të skuadrës, përpara se të kalojë në klubin turk Galatasaray. Qëndrimi i tij në Turqi ka zgjatur pak, megjithëse atje ishte kthyer në ishull të tifozëve. Italia, më afër Shqipërisë e me një kampionat prestigjioz, duket se ka tërhequr shumë qendër-fushorin shtatlartë.

Dj Edi
Muzike e zgjedhur shqiptare per gezimet tuaja familjare
cel: **3311551939**

Rreth 10% e futbollistëve të rinj në Itali janë të huaj

Figc, Federata Italiane e Futbollit bën të ditur se gjatë viteve të fundit është regjistruar një rritje e madhe e fëmijëve dhe adoleshentëve të huaj që luajnë në klubet e ndryshme italiane. Tanimë ata janë rreth 10% e 700 mijë të rinjve më moshën 6 deri në 16 vjeç që kanë tesserën e Figc.

Në renditjen sipas prejardhjes radhiten të parët marokenët e tunizianët, më pas

ganezët e nigerianët. Por pas migrameve masive nga Europa lindore, Figc vë në dukje një rritje shumë të madhe të fëmijëve e të rinjve shqiptarë, kosovarë e rumunë.

Sipas disa drejtuesish klubesh lidhja me një skuadër është për fëmijët e emigrantëve një mënyrë për t'u ndjerë më të integruar, një lloj simboli që i vë në të njëjtin nivel me fëmijët italianë. Dikush rrëfen që një



Lorik Cana, përveç se aftësisë dhe talentit të tij sportiv, është shumë i dashur edhe për disa arsye të tjera, që sportdashësit italianë do t'i zbulojnë më vonë. Karakteri i tij vullkanik në fushën e gjelbër, bashkohet në harmoni me zemrën e tij të madhe, karakteristikë e kampioneve të vërtetë. Prej kohësh Lorik Cana është ambasador i Unicef-it dhe i Pnud-it, Programi i OKB-së për Zhvillimin, testimonial në Shqipëri i "Alo 116"-Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët. Lojtari më i shtrenjtë shqiptar i të gjitha kohërave i ka dhënë mbështetje Shqipërisë dhe Kosovës edhe në çastet e vështira. Janë ende të freskëta në kujtesë dhurimet e mijëra eurove në ndihmë të popullatës së goditur nga shpërthimi në Gërdec apo për shkodranët e prekur nga përmbytjet. Në atë kohë në një deklaratë për mediat shqiptare ai u mundua edhe të sensibilizojë opinionin publik "Duke i ndjerë në vete këto pasoja, - shkruante ai në komunikatën për shtyp, - në shenjë solidarizimi me banorët e këtyre territoreve të përmbytura, dhuroj shumë prej 10,000 euro, me destinacion për ndihmë të familjeve të këtij rajoni.

Me këtë rast inkurajoj të gjitha përpjekjet që shteti shqiptar, individë, organizatat dhe vendet mike, të cilët po bëjnë të pamundurën për t'u gjetur sa më afër popullatës së këtyre zonave të prekura nga kjo tragjedi. Në këtë drejtim, shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje të gjithë atyre që kanë sado pak mundësi të ndihmojnë dhe t'u gjenden në çdo formë pranë familjeve të përmbytura duke i ndihmuar ata, për ta kapërcyer këtë situatë".

Futbollisti është kthyer në një simbol të vërtetë të atdhedashurisë. E jo vetëm në shpirt, por edhe në trup. Në krahun e majtë ka një tatuazh me një shqiponjë dykrenare, në të djathtë një përkrenare ilirë, dëshmi edhe e pasionit të tij për historinë. Por trupi i kampionit mbart edhe vargje: në shpinë i lexohet tatuazhi me vargjet: Shqipëri të qofsha falë/Të kam nënë e më ke djallë. E nuk ishte e papritur që pas ndeshjes Shqipëri Biellorusi të kohëve të fundit, me një mikrofon në fushë ndezi tifozët kuq e zi duke thirrur: "Thuajuni të gjithëve nuk ndërrohet kombësia... Nuk shitet shqiptaria...".

Irida Cami

fëmije ganez i kanë dhënë dy diviza, dy çanta e dy palë këpucë. Përveç se për t'u stërvitur ai këto veshje i mbante dhe për në shkollë, ku nuk donte të ndahej nga simbolet e klubit të tij, simbole që i jepnin një lloj krenarie.

Dokumentet e nevojshme për anëtarësim në një klub futboll

Kërkesa për anëtarësim duhet të bëhet duke përdorur modularët e Federatës, të cilëve u bashkëngjiten dokumentet e parashikuara nga normat në fuqi. Para së gjithash duhet një deklaratë e

noterizuar e nënshkruar nga futbollisti dhe prindit e tij në të cilën deklarohet nëse ai ka qenë apo jo qenë i anëtarësuar në federatë jashtë vendit. Nëse ka qenë i anëtarësuar diku tjetër, kërkesa nuk mund të lëvrohet nga Komiteti Vendas, por nga

”

Tashmë të huajt janë rreth 10% e 700 mijë të rinjve me moshën 6 deri në 16 vjeç që kanë taserën e Figc

Zyra e Tësimeve të Figc. Dokumentet e tjera të nevojshme janë: një certifikatë regjistrimi në shkollë, certifikata e lindjes (lëshuar nga komuna e banimit nëse lojtari ka lindur në Itali, ose dokumenti i barazvlefshëm ku të dëshmohet datëlindja, fotokopje e pasaportës ose i një dokumenti identiteti i lojtarit dhe i prindërve të tij; certifikata e banimit dhe e përbërjes familjare të lëshuar nga komuna e banimit të fëmijës dhe prindërve të tij si dhe lejeqëndrimet e të miturve e prindërve. Nëse lejeqëndrimi është i skaduar, mund të paraqitet kopja e lejeqëndrimit të vjetër dhe kërkesa për përtëritjen.

Chievo Verona blen futbollistin kosovar PËRPARIM HETEMAJ

Chievo Verona ka blerë për një milion e 250 mijë euro gjysmën e kartelës së futbollistit kosovar Përparim Hetemaj. Gjysma tjetër i mbetet klubit të Brescias ku qendërfushori ka filluar të luajë që më 1 shkurt të vitit 2010



Përparim Hetemaj ka lindur në Skënderaj më 12 dhjetor të vitit 1986. Por vetëm pak vjet më pas, në 1992 familja e tij është transferuar në Finlandë, fillimisht në Oulu e më pas në Helsinki. Pas një periudhë të kaluar në disa klube finlandeze, Përparimi ka luajtur edhe në Greqi e Qipro. Në kampionatin italian ka luajtur 30 ndeshje e ka shënuar 2 gola. Madje ai ka veshur edhe fanellën e kombëtares finlandeze, megjithëse në zemër ka Kosovën. Në disa intervista ka përsëritur se "nëse do të ekzistonte kombëtarja kosovare, ëndrra e tij do të ishte të luante me të".

Familja Hetemaj ka nxjerrë dy futbollistë, që të dy luajnë në klubet italiane. Mehmeti luan tek Albinoleffe, kur se Përparimi mbetet në serinë A

me Chievo Veronën. Të dy kanë luajtur në disa skuadra europiane, por me sa duket kanë ndalur në Itali. Ku të dy nuk harrojnë familjen: Mehmeti luan me fanellën numër 58, viti i lindjes së nënës, ndërsa Përparimi kishte numrin 56, viti i lindjes së babait.

Por janë shquar jo vetëm burrat e familjes Hetemaj; edhe motra e futbollistëve, Fatbardha nuk ka mbetur prapa. Në prill të këtij viti, megjithëse shumë e re, vetëm 25 vjeç, ajo kishte hedhur kandidaturën për deputete në Parlamentin finlandez. Për fat të keq ajo nuk arriti kuotën prej 5.000 votash që i mjaftonin për t'u bërë deputete, preferencat për të qenë "vetëm" 4.715 vota.

Ir.Ca.

KLAUDIO NDOJA një gladiator në Brindisi



Basketbollisti Klaudio Ndoja ndërron skuadër. Ai kalon nga Ferrara tek Enel Basket Brindisi, skuadër që konfirmon dhe një herë synimin për t'u mbështetur tek lojtarë të nivelit të lartë.

Ndoja, i lindur në Shkodër

më 18 maj të 1985, jeton në Itali që në moshën 13-vjeçare. Karriera e tij ka filluar në skuadrate kategorive të ulëta si S.Antimo e Borgomanero, e më pas në Serinë A me klubin e Orlandina. Por rënia nga kategoria e kësaj skuadre, bëri që Ndoja të vazhdojë të luajë në Legadue edhe me Scafati Basket deri sa në vitin 2009 transferohet tek Aurora Basket Jesi. Në gusht të vitit 2010 kalon në Basket Club Ferrara. Konsiderohet i aftë të luajë në role të ndryshme, megjithëse natyrisht ai preferon të luajë në sulm. Karakteri shumë i fortë dhe vendosmëria në fushën e lojës, bashkë me fuqinë e madhe të fizikut të tij prej mbi dy metrash, kanë bërë që tifozët të thërresin prek kohësh "gladiator". E është e pashmangshme që në çdo skuadër ku luan, Klaudio Ndoja të kthehet në leader të vërtetë.

WIND LEVERDIS EDHE NGA SHQIPËRIA.



DAILY TRAVEL MONDO.

TELEFONON ME 50 QINDARKA DHE MERR TELEFONATAT ME 40 QINDARKA NË MINUTË.
PA SHKREHJE NË PËRGGJIGJE.

Për ata që aktivizojnë Daily Travel Mondo brenda 4/9/2011, kostoja e aktivizimit prej 5€ është **falas**.
Paguaj vetëm për aq sa flet. Kështu flet, merr telefonata dhe kursen, edhe nga Shqipëria.

ZBULO OFERTËN NË PIKËSHITJET WIND

Kostoja ditore: 2€ që paguhet vetëm në çastin e telefonatës së parë që bën apo merr,
dhe vlen deri në 24.00 (ora italiane). Me parapagesë çdo 60 sekonda.
Opsioni u aplikohet telefonatave drejt rrjetit fiks dhe celularëve të Zonës së BE-së.
për më shumë informacione mbi kostot, kushtet dhe kufizimet shko në wind.it


WIND
Più vicini.

SHKODRA LIFE

jeton
në Torino

Janë të shumta shoqatat kulturore-artistike të komunitetit shqiptar në Itali të krijuara, sidomos vitet e fundit, tek të cilat që nga emërtimi dallojmë disa karakteristika, që na "njoftojnë" dhe për strukturën e objektivat që kanë. Si emërues i përbashkët gjejmë fjalët "kulturore" dhe "shqiptaro-italiane" e nëse do të ndalemi te ky përcaktim i fundit, për të kuptuar më tepër do të vëmë re se iniciativa e krijimit të shoqatës është e shqiptarëve, ndërsa pjesëmarrja si anëtarë të shoqatës apo si bashkëpunëtorë në organizimin e aktiviteteve të qytetarëve italianë është një numër gjithnjë në rritje dhe tashmë i konsiderueshëm.

Ky fakt, që në vitet e para pothuaj rezultonte si një sforcim dypalësh, sot është një fenomen i natyrshëm, që merr ngjyrat e një bashkëpunimi të vërtetë, me synim njohje të ndërsjellë e që përmban një dozë jo të vogël kurioziteti. E gjitha kjo, jo vetëm falë shkallës së integritimit që shqiptarët kanë arritur në secilin territor italian ku banojnë e punojnë, por lidhet ngushtë edhe me nivelin cilësor të aktiviteteve.

Gjithsesi, jo gjithnjë ndodh kështu. Nëse do të kishte një bankë të dhënash të shoqatave shqiptaro-italiane në Itali, mbase lista do të ishte e gjatë, por nëse do të bëhej një bilanc i jetëgjatësisë së tyre, këtu optimizmi i fillimit do i linte vendin zhgënjimit. Ky fakt na dëshmon se një gjë është dëshira për t'u organizuar e prezantuar në këtë shoqëri me një shoqatë, dhe tjetër gjë është jetëgjatësia e vetë iniciativës. Natyrisht mungesë përvojë, mungesë e një organizimi të brendshëm si dhe në përcaktimin e objektivat të qarta. Kështu kemi parë shoqata që janë hapur e mbyllur brenda pak muajsh, të tjera që kanë bërë dy-tre aktivitete me shumë bujë, por që janë pasuar nga një heshtje e gjatë. Gjithsesi edhe këto suksese apo dështime të dikujt janë mësim për të tjerë që kanë dëshiruar të eksperimentojnë në këtë sistem shoqatash.

”

Objektiv i rëndësishëm është edhe njohja nga ana e torinezëve me kulturën dhe artit tonë. E shohim këtë fakt si një urë lidhëse ndërmjet qytetarëve të Torinos pa dallim prejardhjeje. Sepse arti lidh, arti është një gjuhë e përbashkët që nuk ka nevojë për përkthyes për t'u kuptuar dhe vlerësuar

Ky fakt, një mësim për shoqatat e reja që në përcaktimin e objektivave duke pasur parasysh si bazë kryesore rezervat e brendshme të shoqatës, anëtarët e saj, formimin, kapacitetin, cilësinë e tyre e deri në planifikimin e aktiviteteve që u përshtaten kërkesave por dhe që në njëfarë mënyre përcaktojnë identitetin e shoqatës, e bëjnë që të dallohet nga simotrat të spikatë e të tërheqë vëmendjen e opinionit apo dhe të mediave.

Të tilla nuk janë shumë në Itali, një prej tyre është shoqata "Shkodra Life". E veçanta, thelbësorja nuk ndalet vetëm të emërtesa, "jehona" do të ishte rajonale, por qëndron të aktiviteteve të përzgjedhura, te tradita e tyre e kthyer në normë-rregull e që përbën dhe sekretin e transformimit të shoqatës në një pikë referimi për komunitetin e shqiptarëve në Torino, garanci për shtimin e radhëve të saj.

"Festa e luleve" është një nga aktivitetet që e dëshmoi "tezen" e mësipërme. Aktiviteti i spikatur, i cili risjell një nga traditat antike të qytetit të Shkodrës. Një aktivitet që rizgjoi ndjenja te brezi i vjetër si dhe i përcjell ato te brezi i ri, i cili ndofta Shkodrën e njeh vetëm nëpërmjet bisedave familjare, fotove e kujtimeve të prindërve.

Nëse edicioni i parë i "Festa e luleve" ishte një eksperimentim dhe për vetë iniciatorët, përsëritja e suksesshme këtë vit, dëshmoi për dobinë e festës dhe njëkohësisht detajoi akoma më shumë objektivat e shoqatës për një stad të ri cilësor.

Po kush është kjo shoqatë, si lindi dhe çfarë dëshmojnë këto vite jete të saj në Torino ku ekzistojnë dhe shoqata të tjera shqiptare, që me sukses organizojnë aktivitete për po këtë komunitet. Kërkuam të mësojmë historinë, realitetin dhe perspektivat e saj nga dy protagonistet kryesore, nga

presidenti Mark Gera, që është dhe iniciatori i krijimit të saj dhe Esmeralda Tyli, moderatore e mbrëmjeve letrare dhe artistike dhe bashkëpunëtorë e shumë aktiviteteve të tjera si dhe zëdhënese shtypi për shoqatën.

Dy fjalë për lindjen e shoqatës "Shkodra life".

Mark Gera: Krijimi shoqatës u bë si përgjigje e një kërkese që vetë realiteti i emigrantëve shqiptarë në Torino paraqiste: niveli i integritimit, nevoja për konfirmim vlerash e traditash të origjinës, pjesë e identitetit të mërgimtarit ku esencën e përbën pikërisht kultura e vendlindjes. Kështu lindi "Shkodra Life" - emri më shumë se çdo gjë tjetër "denoncon" aspiratat e shoqatës.

Cilat keni përcaktuar si objektiva kryesore të shoqatës?

Mark Gera: Objektivat e shoqatës sonë janë shumë të thjeshtë: përcimi i traditave shqiptare dhe shkodrane në veçanti brezit të ri, që rritet në

shoqërinë italiane. Një objektiv tjetër po kaq i rëndësishëm është edhe njohja nga ana e torinezëve me kulturën dhe artit tonë. E shohim këtë fakt si një urë lidhëse ndërmjet qytetarëve të Torinos pa dallim prejardhjeje. Sepse arti lidh, arti është një gjuhë e përbashkët që nuk ka nevojë për përkthyes për tu kuptuar dhe vlerësuar.

Cilat aktivitete të shoqatës do të veçonit si më të spikaturat?

Mark Gera: Në një vit e gjysmë aktivitete, mund të them që lista e iniciativave të organizuara nga vetë ne si shoqatë dhe e atyre në bashkëpunim me shoqata të tjera italo-shqiptare të territorit është shumë e pasur. Ne u paraqitëm përpara publikut menjëherë në muajin e parë të krijimit të shoqatës me një program të caktuar në Festën e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 2009. Që nga ai moment kemi vazhduar në mënyrë të pandërprerë. Më 30 Prill 2011, në sallën e Teatrit ATC në Torino, shoqata kultur-

vijon në faqen 17



Një ndër shoqatat kulturore të shqiptarëve në Itali është shoqata "Shkodra Life". E veçanta nuk ndalet te emri, "jehona" do të ishte rajonale, por te tradita e aktiviteteve të përzgjedhura, që përbën dhe sekretin e transformimit të shoqatës në një pikë referimi për komunitetin e shqiptarëve në Torino, garanci për shtimin e radhëve të saj.

Bisedë me Mark Gerën, iniciator të krijimit të shoqatës "Shkodra Life" dhe Esmeralda Tyli, moderatore e mbrëmjeve letrare e artistike, dhe zëdhënese shtypi për shoqatën





A I KE SHTATË
LIQENET E LURËS
NË KOPËSHT?



SIGNORINA,
UNA
SCHEDINA!

MUND
TË FITOSH
JACKPOTIN
MILIONER.



SuperEnalotto 

ËNDËRRIMTAR LIND,
MILIONER BËHESH.



Nëse nuk ke mbushur 18 vjeç, nuk mund të luash.



Shkodra Life jeton në Torino

bishme pjesëmarrjen, vlerën e saj (e të shoqatave në përgjithësi) për raporte sociale, njohje e kontribut në integrim?

Esmeralda Tyli: Jetojmë në një periudhë paksa të çoroditur nga ana politike, sociale e morale. Jetojmë në një periudhë tranzicionesh të mëdha si në Shqipëri e në Itali, ashtu edhe në rang botëror. Aty ku politika e integritimit në Itali ka falimentuar, për arsye të cilat nuk dëshiroj të analizoj duke mos qenë unë as politikane dhe as studiuese e socio-politikës, roli individual dhe i grupeve të organizuara në shoqata bëhet shumë i rëndësishëm. Me aktivitetet që zhvillojnë shoqatat në aspekte të ndryshme, të cilat janë bazë e këtyre aktiviteteve, bëhen urë lidhjeje ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij italian. Është rol i rëndësishëm ky, sepse tregon pjekurinë e ndërgjegjes së përgjithshme të komunitetit tonë, i cili nuk e ndien veten që mund të përcaktohet si komunitet i qytetarëve extra, extradiçka. Extra ne nuk e ndiejmë veten; jemi qytetarë që jetojmë dhe punojmë në shtetin italian, japim kontributin tone në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të kësaj shoqërie, jemi qytetarë të kësaj shoqërie me detyrat dhe të drejtat që Kushtetuta e Italisë na përcakton. Si të tillë

ne tashmë e trajtojmë veten dhe si të tillë dëshirojmë të trajtohem nga shoqëria italiane duke filluar nga politika dhe mediat e duke përfunduar deri tek fqinji i vendbanimit. Ne risim dhe edukojmë një pjesë të brezit të ri, i cili do të jetë e ardhmja e kësaj shoqërie, prandaj roli ynë është tepër i rëndësishëm për të pasur një të ardhme sa më të shëndoshë nga ana shoqërore, ekonomike e morale.

Po zgjatem paksa në këtë pyetje, duke qenë shumë e gjerë dhe interesante; më zgjon pa dashje mendime.

Forca e "Shkodra Life" qëndron në faktin e vetëdijes për atë çka jemi dhe çfarë dëshirojmë. Jemi qytetarë me origjinë shqiptare, nga Shkodra e lashtë dhe e pasur me histori, kulturë, art e tradita. Dëshirojmë t'u përçojmë këto tradita brezave që vijnë, të cilët do t'i përpunojnë dhe do t'i vazhdojnë sipas konteksteve shoqërore dhe historike në të cilat jetojnë, duke ruajtur vlerat dhe originalitetin e tyre. Dëshirojmë që kjo pasuri, ky bagazh që secili prej nesh ka sjellë me vete të bëhet një urë lidhëse e natyrshme dhe e shëndoshë ndërmjet komponentëve të shoqërisë tashmë multietnike italiane, duke qenë bazë e njohjes reciproke nëpërmjet tyre.

Albana Temali, Bologna

vijon nga faqja 15

ore shqiptaro-italiane "Shkodra Life" organizoi aktivitetin "Festa e Luleve", i cili jo vetëm arriti suksesin e parashikuar por na dëshmoi se iniciativa ishte mëse "e goditur" e tashme kthehet në traditë eventesh për shoqatën.

Esmeralda, po për ju ç'është "Shkodra-life": thjesht një shoqatë, një kolektiv miqsh apo një "ide" e cila duhet t'a zhvilluar?

Esmeralda Tyli: Një grup miqsh me një ide që duhet zhvilluar dhe përçarur brezave që vijnë: ky është përcaktimi që unë i jap Shoqatës "Shkodra Life". Madje, ndoshta fjala "ide" e thjeshtëzon paksa përmbajt-

jen e vërtetë të aktiviteteve të shoqatës. Sepse arti dhe kultura qytetare shkodrane janë një realitet, një entitet, një pjesë përbërëse e artit dhe kulturës shqiptare, të cilat janë të lidhura me njëra-tjetrën në një mënyrë të pazgjidhshme. Pikërisht këtë realitet dëshirojmë të sjellim në terrenin torinez dhe italian në përgjithësi. Këtë realitet kërkojmë t'u përçojmë brezit të ri që rritet në një habitat të globalizuar botëror.

Drejtuese e disa aktiviteteve të "Shkodra-life" dhe e këtij edicioni të dytë të "Festa dei Fiori", në Teatro ATC. Çfarë shënojnë për ju këto eksperiencat por dhe për anëtarët e tjerë të shoqatës?

Esmeralda Tyli: Shoqata është një grup individësh me talente dhe dhunti natyrore të ndryshme. Secili sjell në shërbim të grupit diçka nga vetvetja, nga bota e brendshme e tij. Mund të them që secili zbulon edhe dhunti të reja që nuk ka ditur që i zotëron. Është ky një fakt pozitiv, sepse ndoshta në jetën e përditshme nuk kemi mundësi të vëmë në shërbim të shoqërisë kapacitetet tona të plota, sepse nga ana profesionale nuk jemi të drejtuar në fushat që na përkasin. Kështu që Shoqata dhe aktivitetet e saja bëhen si një terren i përshtatshëm për shprehjet personale të secilit, të vena këto në shërbim të një projekti të përbashkët.

Cili është komenti më domethënës që keni marrë pas shfaqjes?

Esmeralda Tyli: Komentet që morëm ishin entuziazuese. Sepse programi i larmishëm, i bazuar në

këngët tashmë të mirënjohura qytetare shkodrane, këngët e muzikës së lehtë shqiptare si edhe këngët e mirënjohura të repertorit italian dhe ndërkombëtar, dhanë një larmi idesh dhe emocionesh. Shumë spektatorë na dhanë mendimin që shoqata ka bërë një rritje shumë cilësore në aktivitetet e saj, në kaq pak kohë veprimtarie. Mos harrojmë që shoqata jonë ka veç një vit e gjysmë që është krijuar. Ky fakt na gëzon, por edhe na vë përpara një përgjegjësi të madhe. Sepse kërkesat e publikut rriten çdo ditë, dhe ne dëshirojmë të jemi në një hap me këto kërkesa.

Ku mendoni se qëndron forca e "Shkodra Life" dhe sa e konsideroni të do-

”

Jetojmë në një periudhë paksa të çoroditur nga ana politike, sociale e morale. Jetojmë në një periudhë tranzicionesh të mëdha si në Shqipëri e në Itali, ashtu edhe në rang botëror. Aty ku politika e integritimit në Itali ka falimentuar, për arsye të cilat nuk dëshiroj të analizoj duke mos qenë unë as politikane dhe as studiuese e socio-politikës, roli individual dhe i grupeve të organizuara në shoqata bëhet shumë i rëndësishëm



Telefono në Shqipëri me 5 cent.€/min. Tani po që e ndien pranë vendin tënd.

VRAPO NË NJË 3 STORE OSE TELEFONO 4040 DHE AKTIVIZO MENJËHERË "WELCOME TO ITALY".



3	TIM	VODAFONE	WIND
5 cent.€/min	9 cent.€/min vs celularë 6 cent.€/min vs rrjeti fiks	10 cent.€/min	10 cent.€/min vs celularë 5 cent.€/min vs rrjeti fiks

DO TË KESH EDHE



MINUTA FALAS

NË MUAJ PËR TË FOLUR ME TË GJITHË MIQTË E TU **3** NË ITALI.

PËR TË GJITHË, NË 3 STORE, NJË KOPJE FALAS E KUSHTETUTËS ITALIANE NË VERSIONIN SHUMËGJUHËSH. DERI NË PËRFUNDIMIN E REZERVAVE.

3: Welcome to Italy, telefonatat ndërkombëtare parashikojnë një shkrehje në përgjigje prej 16 cent.€, me tarifim për sekondë. Telefonatat me numrat 3 në Itali parashikojnë një kufi ditor prej 30 minutash telefonata; përtej kufirit 9 cent.€ dhe shkrehje në përgjigje prej 15 cent.€. Në përfundim të afatit përtëritje automatike për 30 ditë kundrejt koston 2€. Opsion i vlefshëm vetëm në Itali nën mbulimin kombëtar të 3. Trafiku i kryer jashtë mbulimit kombëtar 3 do të tarifohet sipas tarifave të parashikuara nga Planit Tarifor. I papajtueshëm me planin rimbushës Super 0 Mondo dhe me planet e Abonimit. **TIM:** Tim Card Albania parashikon shkrehje në përgjigje prej 16 cent.€ dhe tarifim të parapaguar për çdo 30 sekonda. **VODAFONE:** Vodafone One Nation 10 parashikon shkrehje në përgjigje prej 19 cent.€ dhe tarifim të parapaguar për çdo 60 sekonda. **WIND:** Opsioni Call Your Country Wind parashikon shkrehje në përgjigje prej 16 cent.€ dhe tarifim të parapaguar për çdo 60 sekonda. Kosto semestrale prej 4€, falas në promovion për 6 muajt e parë. Krahasimi i bërë sipas tarifave të nxjerra nga faqet Internet Institucionale të Operatorëve më 03/04/2011. Për informacione mbi mbulimin dhe kushtet www.tre.it o i 3-Store.



Tre.it

Një ide e thjeshtë, por gjeniale, që s'ka si të mos konsiderohet e tillë, kur me realizimin e saj, artisti kosovar nuk ka prezantuar thjesht veten e tij apo artistë të tjerë bashkëkombës në një sfond kaq të rëndësishëm ndërkombëtar siç është Biennale-ja, por ka promovuar njëkohësisht Republikën e Kosovës, që ka aq nevojë të njihet në botë.

"Importante è partecipare!" - thotë një shprehje italiane e që dëgjohej shpesh në konkurse. Ne do ta huazojmë në këtë rast, për këtë dalje qoftë edhe "virtuale" të Kosovës me artistët e saj, në këtë skenë ndërkombëtare. Kosova është në Biennale, paçka se "brenda apo jashtë" (nënkupto në aktivitetet e Biennales apo në ato të bashkërenduara të saj), paçka se "fizikisht apo virtualisht". Kosova u përmend, u pa, dhe për Kosovën u fol nëpërmjet artistëve të saj. Arti lidh, bashkon, ngre ura mes popujsh e vendesh, shpesh më shpejt e më me efikasitet se mbledhjet bilaterale politike. Kjo pjesëmarrje mund të konsiderohet një dhuratë për atdheun, Kosovën nga bijtë e saj artistë.

Në një komunikatë shtypi të sitit UnDo.net, i cili dhe publikon eventin dhe videon e realizuar me veprat e artistëve kosovarë, sqarohet se ideja për këtë jo-pavilion jo-zyrtar virtual për Kosovën në Biennale lindi pothuaj rastësisht nga takimi i artistit kosovar Gjokë Gojani me Steve Piccolo, artist sound amerikan, i cili i ka dhënë dhe leksione artistit kosovar në Akademinë Carrara të Bergamos.

Gjoka kontaktoi dhe ftoi në "Virtual Kosovo Pavilion", artistë të tjerë kosovarë, që të dërgonin në formë digjitale veprat e tyre. Dhe kështu u realizua videoja me emrin "Virtual Kosovo Pavilion", që zgjat 6:19 min, ku "eksponojnë" me radhë artistët me veprat e tyre: Gjokë Gojani (I miss my enemies), Ibrahim Aliu (Picture gardens), Faton Aliu (Landscape in red Planet), Vilsona Blakaj (Sunny rays into my soul), Ilir

Edhe KOSOVA në Biennalen e VENECIAS

Për të përfaqësuar Republikën e Kosovës, më të renë e Ballkanit, në Ekspozitën Ndërkombëtare të Venecias (e njohur me emërtimin Biennale di Venezia) ka menduar artisti kosovar Gjokë Gojani me "Unofficial virtual Kosovo nonpavilion"

Balaj, (Missing identity), Dukagjin Idrizi (Legendary tale), Dini Begolli (Dinner for my enemies), Petrit Halilaj (Back to the future, installation), Lavdiqe Murtezi (Without a movement, there is

no improvement), Arian Rogova (Prishtina library of war), Arbana Hajredinaj (Elemosynary performance), Artan Balaj (Ku Klux Klan), Albulena Haxhibeqiri (Dog's portrait on human

character), Korab Kusari (Trying to hold my enemy), Luan Bajraktari (Flowers for the enemy), Valon Begolli (Mercy), Libert Shkopolli (L'art est dans l'oeil de celui qui regarde!!), Petrit Gora (Artists statement), Nexhat Krasniqi Nekra, Luan Kotori (Teacher).

Vepra këto, që trajtojnë një tematikë që përkon me temën e "I miss my enemies" (eksponitë e kuruar nga Oxana Maleeva, ku merr pjesë mes të tjerëve edhe artisti shqiptar Adrian Paci), që do të prezantojë "Virtual Kosovo Pavilion" në eventin final të saj në Biennale.

Gjithashtu "Virtual Kosovo Pavilion" është inkuadruar në "Biennale Alterground" të promovuar në Undo.net ku kontribuojnë studiues dhe artistë, të cilët ofrojnë këndvështrimin e tyre e një lexim original mbi këtë edicion të 54-t të Biennale-s së Venecias.

Albana Temali, Bologna



Të rinjtë shqiptarë të Torinos sjellin në Bra "Pallatin 176"

Kush nuk e mban mend humorin e "Pallatit 176"? Kush nuk ka dëgjuar apo përdorur të paktën njëherë një batutë të atij teatri aq të suksesshëm?

Më 23 korrik, në orën 21.00, kush jeton në provincën e Cuneos, apo më mirë akoma në Bra, ka mundësinë të shijojë pjesë të asaj komedie. Shoqata Youthink në bashkëpunim me Grupin "176 Idee", Artin Picarin, me mbështetjen e shoqatës Artemia, Rrjetit italian të Kulturës popullore dhe të Komunës së Brasë vë në skenë fragmente të kësaj komedie. Shfaqja do të jepet në Pallatin Traversa në Bra - Muzeu i Arkeologjisë, Historisë dhe Artit, rruga Parpera 4, Bra.

Pallati 176 është një komedi teatrale e vitit 1985. Në rrethana kulturore të mbizotëruara nga realizmi socialist, po dukeshin - edhe pse të zbehta - dritat e para të ndryshimit të ardhshëm. Kjo pjesë teatrale arrin të japë me zhdërvjelltësi dhe humor probleme, zakone dhe manitë të familjeve shqiptare në mëdyshje mes ngurtësisë së sistemit komunist



dhe kërkimit të një normaliteti - qoftë edhe vetëm në dukje - në jetët e tyre të përditshme. Shumë shpejt Pallati 176 fiton famë mbarëkom-

bëtare si asnjë tjetër pjesë teatrale. Publiku i të gjitha moshave e ka bërë aq për vete komedinë sa batutat e saj u bënë pjesë e gjuhës së përdit-

shme, madje përdoren edhe sot nga të rinj që as nuk kishin lindur kur Pallati 176 u shfaq për të parën herë.

Shoqata kulturore Youthink lind në vitin 2006 nga takimi mes personash me karakteristika të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, por me një pikë të përbashkët: Torinon, qytetin ku jetojnë. Emri i zgjedhur nga shoqata, Youthink, simbolizon punën kërkimore themelore të këtij grupi: për mendimin e ri.

Grupi teatral 176 Idee, i përbërë nga të rinjtë Aldi Pupuleku, Evelina Skara, Imelda Ali, Dafina Ikononi, Eliona Sako, Leonard Kokthi, Ervin Metko, Jonila Basho, Auora Kokici, Gerta Beqiri, Ana sako, ka prezantuar me sukses pjesë nga kjo komedi edhe verën e shkuar në Torino, gjatë Festivalit ndërkombëtar të gojëdhënave popullore.

LULI BITRI, aktorja më e mirë e Festivalit Vernon në Francë



Filmi "Amnistia" i Bujar Alimanit i ka dhuruar aktores Luli Bitri çmimin "Aktorja më e mirë" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Vernon në Francë për interpretimin e rolit protagonist të Elsës.

Bitri, e cila prej vitesh jeton mes Tiranës dhe Torinos, shprehet se, për të, gjëja më e bukur është që

ky çmim i erdhi në sheshin e xhirimit ndërsa luante në një film me metrazh të shkurtër. "Për mua është hera e parë që marr çmim si aktorja më e mirë dhe është një ndjesi e bukur të të vlerësojë dikush, ndihem shumë mirë", tha Bitri.

Aktualisht filmi "Amnistia" po konkuron në shumë festivale dhe pas pak ditësh, në 22-30 korrik, Luli Bitri do të jetë në Festivalin e Filmit në Sarajevë, një nga festivalet më të rëndësishme në Ballkan. Edhe në këtë konkurim ajo do të garojë për çmimin aktorja më e mirë.

"Amnistia" produksion shqiptaro-greko-francez është filmi i parë me metrazh të gjatë e regjisorit Bujar Alimani, që e ka realizuar brenda një periudhë shumë të shkurtër, me buxhet të ulët dhe me një staf të rinjsh. Filmi i frymëzuar nga një ngjarje e kronikës shqiptare sjell në ekran marrëdhënien e vështirë të dashurisë mes një gruaje e një burri të cilët njihen rastësisht gjatë vizitave të përmuajshme në burg ku gjenden partnerët e tyre.

Pas premierës në Berlinale dhe më pas në Tiranë, filmi ka konkuruar në disa festivale ndërkombëtare ku është vlerësuar disa çmime.

TIRANA VITI 0 më 21 korrik në Terni



Shoqata Il Pettiroso me kontributin e Krahinës së Umbrias, me mbështetjen e minibashkisë Terni Sud dhe patronazhin e Komunës së Ternit, organizon në korrik shfaqjen e katër filmave të huaj në gjuhë origjinale me titra në italisht. Iniciativa, me titull Mondovisioni, realizohet për të prezantuar krijimtarinë e vendlindjeve të emigrantëve, që qytetarët e Ternit të njohin diçka më shumë për ta, por edhe thjesht për të kaluar një mbrëmje ndryshe nga të tjerat. Shqipëria do të prezantohet me filmin Tirana viti 0 të regjisorit Fatmir Koçi. Filmi do të shfaqet të enjten më 21 korrik, në orën 21.00 në Giardino dell'ex-circoscrizione Ferriera, Via Premuda 6, Terni.

Filmat e tjerë të iniciativës Mondovisioni janë Filantropica, film rumun (14 korrik), I am, film hindi (28 korrik). Më 6 korrik është shfaqur filmi Il sangue verde, me regji të Andrea Segre-së që rrëfen historinë e emigrantëve të Rosarnos.

Tirana viti 0, regjia Fatmir Koçi, 2001



Pas ngjarjeve tragjike të vitit 1997, 23 vjeçari Niku jeton në Tiranë me të ëmën dhe të atin e sëmurë. I ndershëm dhe bujar, Niku është në kërkim të punës por ndien se gjendet mes kaosit dhe vrasjeve. Të gjithë që e rrethojnë flasin vetëm për braktisjen e vendit. Po ashtu edhe Klara, e dashura e tij, e cila ikën në Paris. Pas një historie të hidhur familjare, Klara kthehet për të kërkuar Nikun dhe të dy pushohen nga ideja se mund të duhen vetëm në vendin e tyre.

Regjia: Fatmir Koçi, Skenari: F. Koçi, Reinzi Brandner, Producent: Cine Sud Promotion, Koci Production, Alexis, Film QKK, Muzika: Artem Denisov. Aktorët: Nevin Meçaj, Ermela Teli, Rajmonda Bulku, Robert Ndrejka, Behar Mera, Birce Hasko, Lars Rudolph, Juli Haxhidi, Nigda Dako, Vladimir Metani, Artur Gorishti, Monika Lubonja, Gëzim Rudi, Fatos Sela, Jorida Meta.

SMILING CITIES

Jep idenë tënde për t'i ndryshuar fytyrën Tiranës

Fondi shqiptar për monumentet, Shoqata e Arkitektëve shqiptarë dhe Shoqëria gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar, GIZ, kanë ngritur projektin "Smiling Cities" për rivlerësimin e hapësirave publike urbane në Shqipëri, në të cilin ftojnë të marrin pjesë edhe studentët të arkitekturës dhe të inxhinierisë që jetojnë e studiojnë në Itali, përveç studentëve të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe të universiteteve të tjera private. Projekti është në fazën e tij fillestare, atë të regjistrimit, që mund të bëhet nga data 4 deri më 30 korrik.

"Ky projekt synon të mbledhë projekt-ide nga studentët që frekuentojnë këto degë universitetesh në Shqipëri dhe jashtë. Jemi shumë të interesuar të kemi pjesëmarrje studentësh që janë me studime, që sapo janë diplomuar apo që kanë disa vite që janë diplomuar jashtë shtetit, gjithmonë me mendimin dhe besimin që ata mund të transmetojnë një pjesë të eksperiencës së tyre evropiane si edhe një vizion të bashkëkohor dhe pse jo edhe më modern. Pra nuk ka rëndësi nëse vazhdojnë studimet apo i kanë përfunduar ato. Pjesëmarrja është e lirë, ashtu siç është e lirë dhe fusha e krijimtarisë së tyre" thotë për Shqiptariitalise.com koordinatori dhe projektit Anila Berberi.

Tema e këtij projekti është rivitalizimi i hapësirave mikro-urbane dhe rievilimi monumental në përputhje me ndryshimet e shpejta të imazhit urban; rivitalizim dhe promovim i imazhit të zonave të veçanta të qytetit për një ndjenjë identiteti të përbashkët, për ruajtjen dhe vlerësimin e zonave monumentale, historike, kulturore dhe urbane duke u bazuar tek bashkëpunimi kulturor, multi rajonale dhe multi fetare, për të siguruar një mbrojtje dhe akses më të madh në trashëgiminë kulturore dhe hapësirat publike urbane.

"Projekti ka për qëllim të nxisë debatin publik për zonat e pasura historike dhe monumentale por shpesh të lëna pas dore dhe të kontribuojë në rua-

jtjen dhe rehabilitimin e këtyre zonave. Një pjesë me rëndësi në qëllimet e projektit është edhe tërheqja e vëmendjes së pushtetit vendor për të parë se çfarë dëshiron vërtet rinia, por edhe t'u krijohet mundësi studentëve të njihen dhe të njohin sipërmarrësit e sektorit që lidhen me profesionin e tyre. Me një fjalë, të shërbeje edhe si një kartë vizite për të nesërmen e këtyre arkitektëve, inxhinierëve apo projektuesve të së ardhmes" shpjegon Anila Berberi.

Projekti ka disa faza

Faza 1 - Regjistrimi (4-30 korrik). Për studentet që jetojnë në Shqipëri regjistrimi mund të bëhet pranë sekretarive të Universitetit Politeknik të Tiranës (shtetëror) dhe pranë disa universiteteve private në Shqipëri.

Për studentet që studiojnë jashtë Shqipërisë, ose që kanë përfunduar studimet jashtë dhe jetojnë atje regjistrimi mund të bëhet on-line, duke dërguar të dhënat personale (që kërkohen në formularin e regjistrimit) në adresat e-mail (anila_berberi@hotmail.com ose albanianfm@yahoo.com).

"Nga kategoria e studentëve që studiojnë jashtë Shqipërisë - sqaron Berberi - na intereson që ata të jenë të pranishëm të paktën në çastin e konkursit me punët e tyre, që mund të jenë individuale ose kolektive. Pra nuk është e thënë që të jenë të pranishëm në Shqipëri gjatë gjithë kohës".

Faza 2 - Workshop-e ose seminare (Java e fundit e korrikut dhe gjatë gushtit që sidoqoftë do të përcaktohet më me saktësi edhe në bashkëpunim me vetë studentët). Kjo fazë konsiston në dhënie e punës si dhe në konsulencë. Gjatë projektit janë parashikuar 4 seminare me të gjithë studentët me të dhëna teknike kryesisht të fushës së tyre. Në seminare do t'u shpjegohet edhe se çfarë synon projekti ose se cilat mund të jenë zonat me interes

vijon në faqen 23

Banka jote është e gjitha këtu.



Carta Enjoy. Gjithçka që të nevojitet me vetëm 1€ në muaj!

Për të pasur gjithçka, pa pasur llogari.

Enjoy të lehtëson jetën, sepse të jep të gjitha avantazhet e një llogarie rrjedhëse, pa pasur një llogari rrjedhëse. Për të akredituar rrogën, për të blerë në të gjitha dyqanet dhe në internet, për të tërhequr para falas në mbarë Italinë pranë sporteveve ATM dhe jashtë shtetit në qarkun Mastercard, për të ngarkuar celularin, dhe për shumë shërbime të tjera, zgjidh komoditetin. Zgjidh Kartën Enjoy.

Eja menjëherë në UBI Banca! Për të gjetur filialin më të afërt vizito faqet internet www.ubibanca.com/nuovi-italiani ose telefono në numrin e gjelbër 800 759 759.

PËR MË TEPËR MUND TË DËRGOSH PARA ME



UBI Banca

Mesazh reklamues me qëllime promovimi. Për kushtet e kontratës shiko fletët informuese në të gjitha filialet e Bankave të Grupit UBI Banca.

800.759.759 - www.ubibanca.com

a mund të dërgoj para
në **shqipëri** me

7€* komision?



transferta nga 100€ për në shqipëri duke filluar nga 7€**

shuma	komision*
€0,01 - €100	€7,00
€100,01 - €200	€10,00
€200,01 - €300	€13,50
€300,01 - €400	€17,00

shuma	komision*
€400,01 - €600	€26,00
€600,01 - €800	€34,00
€800,01 - €1.000	€44,50

oferta është e vlefshme nga 3 nëntori 2009 në të gjitha agjencitë western union në lombardi, emilia romagna, piemonte, liguria, valle d'aosta, trentino alto adige, veneto, friuli venezia giulia, toskana dhe lazio.

*fondet në përgjithësi janë të disponueshme në pak minuta në varësi të abeteve dhe kushteve të shërbimit, duke përfshirë dhe oraret e agjencive si dhe ndryshimet në orën lokale, për më tepër shikoni formularin e dërgesës për kushtet.
**përveç komisionit, western union përfiton para shitesë kur këmben paratë tuaja në mënyrën vendase. komisionet standarte fillojnë me €1000,01 të dërguara në një transakcion, për listën standarte të komisioneve ju lutemi, vizitoni agjencitë tona.

WESTERN UNION | *yes!*

familja juaj mund t'ju ndiejë pranë me një transfertë parash, kudo që ju mund të ndodheni.

www.westernunion.it

+355 42 23 49 79

transfertë parash

KLEDI E ANBETA kërcejnë Napolonin në studiot e Canale 5

Kledi Kadiu ftohet në emisionin Pomeriggio Cinque për të treguar për jetën e tij private. Një përshëndetje e veçantë për Kledin gjatë emisionit nga ambasadori Llesh Kola "Unë jam ambasadori i radhës, ti je ambasador i përhershëm", që falënderon edhe të gjithë shqiptarët që i ngrenë lart imazhin Shqipërisë

Një nga të ftuarit e programit të pasdites së Canale5, Pomeriggio Cinque, më 5 korrik, edhe balerinin shqiptar Kledi Kadiu, i prezantuar nga Barbara D'Ur-

ditëve e të motrës "dita më e bukur e jetës". Natyrisht pa harruar impenjimin e tij në fushën sociale, me UNICEF.

E gjatë intervistës, një surprizë e bukur për Kledin: bale-

ambasadorit të Shqipërisë në Romë, Llesh Kola, i cili kujton që Kledi është Ambasadori i Kombit, që e falënderon për kontributin e vyer që ai ka dhënë për ngritjen e imazhit të Shqipërisë. "E them gjithnjë" - thotë ambasadori. - "Unë jam Ambasadori i radhës, ndërsa ti je ambasador i përhershëm". Ambasadori kujton me kënaqësi një episod të vitit 2008 kur ka qenë i pranishëm festivalin e Këngës në Sanremo: "E mban mend kur më shoqërova në Sanremo? Atëherë pashë me sytë e mi dashurinë e italianëve për ty. Dhe unë nga një person i shoqëruar u ktheva në shoqëruarin tënd. Kjo më bëri të ndihesha krenar për". E më pas përshëndet të gjithë shqiptarët që me ndershmërinë e punën e tyre bëjnë aq shumë për imazhin e vendit të tyre.

Ndërsa biseda e Kledit me drejtuesen e emisionit vazhdon, nuk kanë të sosur miqtë e tij që në sallë apo në video e përshëndesin e nxjerrin në pah anë të ndryshme të shokut të tyre: Ilir Lushi nga Tirana kujton i ka çuar familjes së tij, dhuratat e para që Kledi u bënte; Bruna e Michele, miqtë

e kledit që nuk takonte prej një viti, vijnë e përshëndesin në sallë dhe i sjellin edhe ëmbëlsirën "tiramisù" të përgatitur nga Bruna e që sipas Kledit është më e mira që ka ngrënë ndonjëherë; Mario Marozzi flet për maninë e Kledit për teknologjinë; Pino Alosa, balerin, kujton që është tepër i përpiktë në orare; Fabrizio Bartoli, balerin tregon për passionin e Kledit për syzat; në zemër të Romës, në Trastevere, ku Kledi ka shtëpinë, flasin me simpati kamerierët e restoranteve që ai frekuenton. Një video prekëse edhe ajo e Maksudës, një vajze të vogël

nga Bangladesh që Kledi ka takuar gjatë vizitës në këtë vend si testimonial i UNICEF-it. Së fundi flet paksa për jetën private, pa u zgjatur shumë, pasi si gjithnjë parapëlqen që jeta private të mbetet e tillë. Por edhe në këtë pikë i kanë përgatitur surprizën me Serenën e njërit prej edicionëve të Grande Fratello-s.



so, për intervistën "Cuore a cuore" si shqiptari më i famshëm në Itali dhe i prituri me duartrokitje të zjarrta nga publiku i pranishëm në sallë. Në një intervistë të gjatë Kledi rrëfen jetën e tij, nga fëmijëria e deri te suksesi i fundit i RAI5, duke kaluar edhe nëpër çaste të rëndësishme të jetës së tij familjare si martesë e para pak

rina Anbeta Toromani, vjen në sallë, e së bashku kërcejnë Napolonin. Vazhdojnë së bashku bisedën duke folur edhe për miqësinë e bukur mes tyre, e duke bërë shaka herë pas here me "gabimet" e italishtes së Kledit.

Një tjetër homazh i përgatitur nga stafi i emisionit për Kledin, edhe përshëndetja e

Edhe ISOLtecnic S.r.l. e Bolonjës mbështet Kombëtaren shqiptare të Regbit

Me një ndihmë prej 400,00 eurosh

Fushatën për mbledhje fondesh në mbështetje të Kombëtares shqiptare të Regbit, për të mundur të mundësuar ëndrrën e tyre të përfaqësimit të Shqipërisë në Olimpiadat e Rio De Zhaneiros 2016, e përkrah një tjetër ndërmarrje. Ditta ISOLtecnic S.r.l. e Bolonjës u ka ofruar një shumë prej 400, 00 eurosh djemve shqiptarë të regbit. Ajo u bashkohet kështu kontribuuesve të parë që janë Impresa edile Arben Myrtaj (100,00 euro) dhe Ditta PIERRE S.r.l. e Pirro Qendros e Redian Hetemit (200,00 euro), si edhe anëtarët e shoqatës Skanderbeg të Bolonjës që kanë mbledhur për kombëtaren 500,00 euro.

Për të mbështetur Kombëtaren shqiptare të Regbit dhe ëndrrën e saj për të arritur në Rio De Zhaneiro është promovuar një fushatë për mbledhje fondesh, e lindur në kuadrin e Festivalit por që po vazhdon.

Dhuruesit mund të derdhin kontributin e tyre me anë të një urdhër-xhirimi bankar në emër të:

Pordenone Ovale ASD

Kodi IBAN: IT 20 K 08356 12503 000000033929

Pranë: BCC PORDENONESE, Agenzia 3, via Mazzini, 47/d - Pordenone (PN).

Emrat e personave dhe ndërmarrjeve që do të japin kontributin e tyre për Kombëtaren shqiptare të Regbit do t'i botojmë në faqet e Botës Shqiptare dhe te shqiptariitalise.com, nëse nisin kuponin e urdhër-xhirit me faks në 051.5076482. Për çdo informacion mbi kontributin mund të telefonohet në 349.7786592, 347.8427680).



SMILING CITIES

Jep idenë tënde për t'i ndryshuar fytyrën Tiranës

vijon nga faqja 20

si edhe disa aspekte që lidhen me ndriçimin, sinjalistikën, historikun etj. Gjithashtu gjatë gjithë periudhës së projektit ofrohet konsulencë. Për studentet që në atë periudhë janë ende jashtë shtetit materialet didaktike do të jepen me anë të medias elektronike. Faza 3 - Konkursi. Është caktuar që të bëhet në shtator. Do të ketë 3 çmime për punimet më të mira, të cilat do të jepen nga një juri ku do të marrin pjesë një anëtar i Fondit Shqiptar për Monumentet, një anëtar i Shoqatës së Arkitektëve Shqiptarë, një përfaqësues i GIZ-it, një përfaqësues i Ministrisë së Turizmit, një

përfaqësues i Bashkisë së Tiranës, një përfaqësues i Institutit të Lartë të Arteve, dhe një përfaqësues i një forumi rinor.

Faza 4 (tetor - nëntor 2011) - Ekspozitë shëtitëse. 10-15 punimet më të mira do të paraqiten në një ekspozitë shëtitëse: në ambientet e Politeknikut, në ambientet e 3 universiteteve private në Tiranë, në një ambient publik në Tiranë, si dhe në dy rrethe të Shqipërisë. Faza 5 (nëntor 2011) - Publikim i një libri me 10-15 punimet më të mira, me tekstin, fotografitë dhe design (në shqip dhe anglisht).

"Kjo është ideja fillestare, por nëse ne do te kemi një

numër edhe më të madh projekt-idesh të mira mund të shtohen. E rëndësishme është që në këtë libër do të futen edhe të gjithë emrat e studenteve pjesëmarrës, me të dhënat e tyre, nr. e telefonit, e-mailin etj. Ky libër do t'u shpërndahet bashkive dhe minibashkive, studiove të arkitekturës dhe inxhinierisë, studiove të design-it që janë anëtarë të shoqatës së Arkitektëve, si edhe shume shoqatave dhe OJQ-ve me të cilat bashkëpunon Fondi Shqiptar i Monumenteve" shpërgojon koordinatoresha e projektit, Berberi.

Keti Biçoku

TIM CARD ALBANIA LIMITED.

Me **6** cent/min flet me të gjithë numrat në Itali dhe numrat fiks në Shqipëri.



Dhe flet me celularët në Shqipëri vetëm me 9 cent/min. Hyr në TIM duke mbajtur numrin tend dhe dyfisho rimbushjet për një vit.

IMPULS NË PËRGJIGJE 16 CENT DHE TARIFIM ME IMPULSE PREJ 30 SEKONDASH.

TELEFONO NË 119, QË SOT EDHE NË GJUHËN TËNDE. OSE HYR NË DYQANET TIM.

Tarifa 6 cent/min është e vlefshme deri në 1000 min çdo 30 ditë për thirrjet drejt Shqipërisë, për thirrjet në drejtim të operatorëve të tjerë celularë vlen për një maksimum prej 200 minutash në javë. Për info mbi kostot pasi të tejkalohehet ky limit hyr në www.tim.it. Oferta promotionale "dyfishimi i rimbushjeve" është e vlefshme për ata që kalojnë nga operatorë të tjerë në TIM deri në 04/09/2011. Parashikon një bonus maksimal prej 50€ çdo 30 ditë.

